

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5942
E premte, 29 nëntor 2019
çmimi 0.40 €

—Heronjtë Hamëz, Shaban dhe Adem Jashari përjetësohen në bronz në Drenas F.7

—Festa e 28 nëntorit, nën hijen e tërmetit që goditi Shqipërinë F.6

—Delegacioni gjerman për vlerësimin e kritereve për vizat zhvilloi vizitë dyditore në Kosovë F.2

—ShBA-ja dhe Britania kërkojnë formimin e shpejtë të institucioneve të reja F.3

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

Muhamet
MAVRAJ



KU PO TE DHEMB SHQIPNI

Shpesh po dridhesh
Po djersitesh
Ku po te dhemb Shqipni

I shlirove lidhesat
Kepucet t'u zvogeluan
A kembet po te rriten
Reume nentosh ndoshta
Ku po te dhemb Shqipni

Nuk je nena ime
As motra e vogel as vellai i madh
As kusherina, s'jemi gje ilake te
genjejme cdo dite ty
Ku po te dhemb Shqipni

as gjysma ime as cereku
Dhe as e tera
Ke mbet veç sa nje kuti
Ku po te dhemb Shqipni

Ngado, ne cdo cep, ne cdo anije, ne
cdo enderr
Na shpon na pershkon na terrqethe
na çorodite
Dridhja jote,
Ku po te dhemb Shqipni

Gjithmone, gjithkund, gjithqysh
kthejme koken kah ti
Edhe ateistet bijne ne gjunj
Te falen ty
Ku po te dhemb Shqipni

Ne emer te Zotit
Je e denuar te mos biesh kurre
As te behesh germadhe
Veç fol Ti

Ku po te dhemb
Shqipni, loçka ime

Faltorja jone e madhe

Prishtine, 28 Nentor 2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KA SHËNUAR 107-VJETORIN E PAVARËSISË
NËN ANKTHIN E TËRMETEVE

RËNDOHET TRAGJEDIA, 46 TË VDEKUR PAS TËRMETIT NË SHQIPËRI



Festa kombëtare e 28 nëntorit ka gjetur Shqipërinë me dhimbje dhe trishtim nga pasojat e tërmetit shkatërrues që goditi të martën Durrësin me rrethinë. Fatkeqësisht, numri i viktimave të

tërmetit prej 6.4 ballësh ka shkuar duke u rritur që nga ndodhja e tërmetit. Ekipe të kërkimshpëtimit të enjten kanë nxjerrë nga gërmadhat edhe viktimën e 45, por raportohet se mund të ketë edhe

viktima të tjera. Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë ka bërë me dije se operacionet e kërkimshpëtimit po vazhdojnë në qytetin e Durrësit, ndërsa janë mbyllur në Thumanë

Varrosen dy vëllezërit nga Gjilani që vdiqën pas tërmetit në Shqipëri



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Stoltenbergu: Evropa nuk mund të mbrohet pa NATO-n

BRUKSEL, 28 NËNTOR - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, tha se deklarata e tij për "vdekjen e trurit të NATO-s" ka shërbyer si një thirrje zgjimi për anëtarët e aleancës. Gjatë një takimi me Sekretarin e Përgjithshëm të Aleancës, Jens Stoltenberg, presidenti francez tha se "ndihet i lumtur që të gjithë tani mendojnë më shumë për qëllimet strategjike". Ai përmendi disa sfida me të cilat ballafaqohet NATO-ja, përfshirë raportet

me Rusinë, çështjen e Turqisë dhe paqen në Evropë. Në një intervistë për revistën "Economist", Macroni kishte deklaruar se "ajo që ne po përjetojmë tani është vdekja e trurit të NATO-s". Deklarata nxit reagime të shumta në mesin e vendeve aleate. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se NATO-ja është e vetmja platformë ku Amerika e Veriut dhe Evropa mund t'i adresojnë çështjet strategjike së

bashku. "Bashkimi Evropian nuk mund të mbrojë Evropën. Bashkimi Evropian nuk mund të zëvendësojë unitetin transatlantik. Një NATO e fortë dhe një bashkim i fortë Evropian janë dy anët e së njëjtës monedhë. Të dyja janë të domosdoshme për lirinë e vazhdueshme dhe prosperitetin e Evropës", tha Stoltenbergu. Samiti i ardhshëm i NATO-s do të mbahet më 3 dhe 4 dhjetor në Londër, për të shënuar 70-vjetorin e aleancës ushtarake.



Delegacioni gjerman për vlerësimin e kriterëve për vizat zhvilloi vizitë dyditore në Kosovë

Përfaqësues të Qeverisë së Kosovës dhe të delegacionit nga Gjermania kanë zhvilluar një seri takimesh në nivel ekspertësh për të diskutuar për punën e institucioneve tona, për të arriturat dhe për përafrimin e proceseve për çështjen e liberalizimit të vizave, duke shtjelluar temat dhe aspektet që kanë të bëjnë me luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionin si dhe me menaxhimin e kufijve dhe migrimit



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 28 NËNTOR - Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Zyra e Kryeministrit, këto dy ditë ishte nikoqire e vizitës së delegacionit nga Gjermania, konkretisht Ministrisë Federale për Punë të Brendshme, Ndërtim dhe Atdhe për çështjen e liberalizimit të vizave. Ky proces që ka dalë nga marrëveshja e kryeministrit në detyrë, Ramush Haradinaj dhe ministrit të Punëve të Brendshme të Gjermanisë, Horst Seehofer, ka për qëllim harmonizimin e procesit të vizave në kuadër të Bashkimit Evropian.

Përfaqësues të Qeverisë së Kosovës dhe përfaqësues të Ministrisë Federale për Punë të Brendshme, Ndërtim dhe Atdhe kanë zhvilluar një seri takimesh në nivel ekspertësh, për të diskutuar për punën e institucioneve tona, të arriturat dhe përafrimin e proceseve për çështjen e liberalizimit të vizave. Takimet e 26 dhe 27 nëntorit në Prishtinë kanë shtjelluar temat dhe aspektet që kanë të bëjnë me luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe menaxhimin e kufijve dhe migrimit. Ekspertët e Kosovës, përfaqësues nga institucionet e Republikës së Kosovës, si Zyra e Kryeministrit, Ministria e

Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Polica e Kosovës, Agjencia e Regjistrimit Civil, Agjencia Kundër Korrupsionit kanë prezantuar para delegacionit gjerman të gjitha procedurat dhe të arriturat e Kosovës në temat të cilat lidhen me këtë proces. Delegacioni gjerman ka parë për së afërmi edhe punën dhe sigurinë që ofrohet në prodhimin e dokumenteve identifikuese, teknologjinë, procedurat dhe sigurinë e lartë në gjithë këtë proces.

Bisedat në nivel ekspertësh në Prishtinë janë mbajtur në një atmosferë konstruktive dhe nga pjesëmarrësit janë vlerësuar si një hap i rëndësishëm për përafrimin e Kosovës me Bashkimin Evropian. Takimet e nëntorit në Prishtinë kanë pasuar pas takimeve që ka zhvilluar delegacioni kosovar në fillim të muajit qershor në Berlin. Ky proces bashkëpunimi ka nisur pas kërkesës së kryeministrit në detyrë, Haradinaj, që shteti gjerman, konkretisht ekspertët e kësaj fushe nga Ministria e

Brendshme, ta vizitojnë Kosovën për të parë punën e bërë. Qeveria e Kosovës ka theksuar se vendi ynë ka plotësuar të gjitha kriteret e vëna për liberalizimin e vizave. Procesi i nisur, bilateral me Gjermaninë, po bëhet me qëllim të identifikimit të arriturave dhe punës që Kosova e bënë, veçmas për ofrimin e sigurisë, për temat si menaxhimi i kufijve, migrimi, menaxhimi i Qendrës për Prodhimin e Dokumentacioneve, Policisë së Kosovës, prokurorisë, luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Ahmeti: Me LSDM-në nuk kemi diskutuar për ndryshimin e modelit zgjedhor

SHKUP, 28 NËNTOR, - Nuk është biseduar për ndryshimin e modelit zgjedhor me partnerin tonë të koalicionit LSDM dhe vlerësojmë se për këtë çështje nevojitet konsensus më i gjerë ndërpartiak, potencoi të enjten lideri i Bashkimit Demokratik për Integritim, Ali Ahmeti, duke iu përgjigjur pyetjes së gazetarëve

në shënimin e Ditës së Flamurit shqiptar në sheshin "Skenderbeu" në Shkup. "Mendojmë dhe vlerësojmë se çështja e modelit zgjedhor është çështje për të cilën duhet konsensus më i gjerë ndërpartiak, kështu që ne mendojmë që të respektohen të gjitha direktivat dhe rekomandimet e

OSBE/ODIHR dhe të komunitetit ndërkombëtar", tha Ahmeti. I pyetur se pse BDI-ja është kundër të ketë vetëm një njësi zgjedhore, Ahmeti u përgjigj se ata kanë sjellë konkluzë se nuk ka kohë të mjaftueshme për diskutim dhe për përpunimin e rregullave të reja zgjedhore. (zhurnal)



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit

ShBA-ja dhe Britania kërkojnë formimin e shpejtë të institucioneve të reja

Pas certifikimit të zgjedhjeve parlamentare të parakohshme të 6 tetorit, ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip Kosnett dhe ai i Britanisë, Nicholas Abbott, kanë bërë thirrje që sa më shpejt të konstituohen institucionet e reja, Kuvendi dhe Qeveria. Për formimin e institucioneve të reja dhe për funksionimin e tyre kanë folur edhe analistët politikë, të cilët kanë vlerësuar se papërgjegjësitë e qeverive të mëhershme, nepotizmi, punësimet me kritere partiake, papërgatitja dhe paaftësia e kadrove, pastaj edhe shpenzimet e pakontrolluara të buxhetit dhe borxhet e papaguara do të reflektohen në punën e qeverisë së re, te secila ministri



Kurti e Mustafa thonë se marrëveshja e koalicionit do të ndodhë në ditët e ardhshme

Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) brenda disa ditëve do ta përmbyllin marrëveshjen për koalicionin e ardhshëm qeverisës. Kështu ka bërë me dije kryetari i LV-së, Albin Kurti, pas takimit që ka pasur të enjten me liderin e LDK-së, Isa Mustafa. "Në ditët ditë në vijim do ta lidhim marrëveshjen e koalicionit", ka thënë Kurti. Ai ka shtuar se takimi ishte konstruktiv. "Do t'i vazhdojmë takimet e komunikimit tonë. Kur t'i kemi rezultatet konkrete do t'ju njoftojmë", u ka thënë Kurti mediave. Edhe lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se takimi me Kurtin ishte i frytshëm dhe konstruktiv. Ai ka thënë se do t'i vazhdojnë takimet me liderin e LV-së edhe në ditët e ardhshme. Mustafa para mediave ka thënë se ia ka uruar fitoren Kurtit që partia e tij ka dalë e para në zgjedhjet e 6 tetorit.

Albin Kurti. Madje për herë të dytë. Në vitin 2017 Albin Kurti ka marrë 143 621 vota, ndërsa kësaj radhe është votuar nga 183 952 persona, duke u bërë përfaqësuesi politik më i votuar në Kosovë qysh prej kur ka filluar aplikimi i sistemit zgjedhor me lista të hapura. Qeveria e ardhshme e LV-së dhe e LDK-së tashmë e ka shumicën e nevojshme në Kuvendin e Kosovës. Mëngjesi i të hënës duhet të na gjejë me marrëveshje të koalicionit qeverisës", thuhet në njoftimin e Lëvizjes Vetëvendosje. Analisti politik Shkëlzen Maliqi, i pyetur për anët e forta dhe të dobëta të kësaj qeverie, ka thënë se është vështirë të bëhen analiza të tilla derisa nuk funksionalizohet qeveria pasi, sipas tij, duhet parë përbërjen e saj dhe zotimet konkrete që i bën rreth prioriteteve. "Mund të flasim tani për mandatin që e ka marrë dhe shpresat që i ka ngjallur rreth ndryshimeve. Përparesia e qeverisë Kurti është se sjell një

rifreskim të konsiderueshëm të lidhshimit, më i ri për nga mosha, gjithsesi më i arsimuar dhe, shpresojmë, edhe profesionalisht më i përgatitur për punët që i presin. Ky rifreskim mund të sjellë entuziazëm dhe energji për përmbushjen e mandatit, por zakonisht kjo nuk është e mjaftueshme. Drejtuesit e rinj mund të kenë ide të mrekullueshme dhe vullnet të madh për realizimin e tyre, por duhet të jenë edhe realistë, sepse shumë gjëra rreth shtetndërtimit në këta 12 vjet janë bërë mbrapsht, si improvizime, janë vendosur si staf permanent në institucione edhe njerëz të paafte, ka zinxhirë të tërë të posteve të rëndësishme politike, ekonomike etj., që nuk mund të zëvendësohen dhe riparohen ose aftësohen me lehtësi, ose edhe pa probleme me ligjet që kufizojnë shkarkimet e tyre", ka thënë Maliqi për "Epokën e re". Ai ka shtuar se papërgjegjësitë e qeverive të mëhershme, nepotiz-

mi, punësimet me kritere partiake, papërgatitja dhe paaftësia e kadrove, pastaj edhe shpenzimet e pakontrolluara të buxhetit, borxhet e papaguara që i kanë lënë pas vetes, arbitrariteti me të cilin i mbushnin bordet e institucioneve dhe agjencive shtetërore dhe publike, të gjitha këto do të reflektohen në punën e qeverisë së re, te secila ministri. "T'i ndreqësh gabimet trashanike të mëhershme merr shumë kohë, do të ketë edhe rezistenca institucionale dhe ligjore. Kjo është një sfidë e madhe për liderët e rinj, duke u nisur nga vetë kryeministri i cili shpesh jepte premtime të nxitura për shkarkime dhe emërimet, që proceduralisht nuk bëhen aq lehtë", është shprehur Maliqi. Ndërkaq analisti tjetër, Artan Muhaxhiri, i pyetur se cilat janë pritjet e tij për funksionimin e qeverisë LV-LDK nëse u referohemi dallimeve që i kanë këto dy parti, ka theksuar se pritjet nga qeveria LV-LDK nuk duhet të jenë të mëdha sepse një pjesë e zinxhirit të sistemit institucional është deformuar strukturalisht dhe kjo nënkupton se korrigjimi i tij do të kërkojë kohë dhe angazhim konstruktiv. "Ajo që është brenda kufijve të së mundshmes për këtë koalicion ka të bëjë me kthimin e normalitetit qeverisës: trajtimin meritore të problemeve të qytetarëve në proporcion me rëndësinë jetike, emërimin e personaliteteve të duhura për udhëheqjen e dikastereve, mënyrën transparente të shpenzimit të parasë publike, si dhe ofrimin e mundësive të barabarta mbi parimet objektive e të padeterminuara nga përkatësitë partiake. Sa i përket imazhit të qeverisjes, qeveria e re nuk do ta ketë shumë të vështirë ta rregullojë atë pasi tashmë është dërrmuar përtokë nga qeveria e kaluar", ka thënë Muhaxhiri.

EPOKA ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 28 NËNTOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që janë mbajtur më 6 tetor 2019.

Kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, ka bërë me dije se ky vendim vjen pas pranimit të konfirmimit nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia dhe nga Gjykata Supreme se nuk kanë ndonjë çështje për ta shqyrtuar dhe vendosur. "Në bazë të rezultateve, Lëvizja Vetëvendosje ka marrë 26.27 për qind të votave, Lidhja Demokratike e Kosovës 24.54 për qind, Partia Demokratike e Kosovës 21.23 për qind, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës në koalicion me Partinë Socialdemokrate ka marrë 11.51 për qind, Lista Serbe 6.40 për qind të votave dhe Nisma Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë ka 5.002 për qind", ka thënë Daka.

Bazuar në numrin e votave të fituara, Lëvizja Vetëvendosje do t'i ketë 29 deputetë në Kuvendin e Kosovës, LDK-ja 28, PDK-ja 24, koalicioni AAK-PSD 13, Nisma Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë 6 deputetë. Ndërsa nga komunitetet joshumicë, Lista Serbe 10 deputetë, si dhe 10 vende kanë fituar së bashku të gjitha partitë e minoriteteve joserbe.

Pas certifikimit të rezultateve, KQZ-ja do ta njoftojë zyrtarisht presidentin e Kosovës lidhur me rezultatin e këtyre zgjedhjeve që hap dyert për konstituimin e institucioneve të reja të vendit. Kuvendi i Kosovës ka 120 ulëse, prej tyre 20 ulëse janë të garantuara për komunitetet joshumicë, përkatësisht 10 për komunitetin

serb dhe po aq për komunitetet e tjera joshumicë.

Neni 66 i Kushtetutës së Kosovës e parasheh mënyrën e konstituimit të Kuvendit. Aty përcaktohet se Kuvendi zgjidhet me mandat katërvjeçar, duke filluar nga dita e seancës konstituive që mbahet brenda tridhjetë ditëve nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve.

Pas certifikimit të zgjedhjeve, ka reaguar ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett dhe ai i Britanisë. Ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett, ka thënë se pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të 6 tetorit është koha për t'u krijuar sa qeveria. "Së bashku me popullin e Kosovës jemi të kënaqur me certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve që u mbajtën më 6 tetor. Tani është koha që qeveria e re të formohet dhe të fillojë plotësimin e premtimeve që u bënë gjatë fushatës elektorale", ka shkruar Kosnett në llogarinë e vet në "Twitter".

Edhe ambasadori britanik në Kosovë, Nicholas Abbott, ka bërë thirrje që sa më shpejt të konstituohet Kuvendi i Kosovës dhe të formohet qeveria e re. "Pas kaq shumë vonesash, rinumërimet dhe ankesa, tani duhet të mblidhet kuvendi i ri në mënyrë që qeveria e re të formohet sa më parë që është e mundur", ka shkruar Abbot në rrjetin social "Facebook".

Pas certifikimit të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit 2019, ka reaguar edhe Lëvizja Vetëvendosje. Kjo parti ka bërë me dije se do ta kenë grupin më të madh parlamentar, me 30 deputetë. 29 prej tyre vijnë nga lista e LV-së, 1 nga IRDK-ja që iu ka bashkuar këtij grupi parlamentar. "Këto zgjedhje janë karakterizuar nga gara e kandidatëve për kryeministra si kurrë më parë. Këtë garë e ka fituar

Republika e Shqipërisë ka shënuar 107-vjetorin e pavarësisë nën ankthin e tërmeteve

Rëndohet tragjedia, 46 të vde

Festa kombëtare e 28 nëntorit ka gjetur Shqipërinë me dhimbje dhe trishtim nga pasojat e tërmetit shkatërrues që goditi të martën Durrësin me rrethinë. Fatkeqësisht, numri i viktimave të tërmetit prej 6.4 ballësh ka shkuar duke u rritur që nga ndodhja e tërmetit. Ekipe të kërkimshpëtimit të enjten kanë nxjerrë nga gërmadhat edhe viktimën e 46, por raportohet se mund të ketë edhe viktime të tjera. Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë ka bërë me dije se operacionet e kërkimshpëtimit po vazhdojnë në qytetin e Durrësit, ndërsa janë mbyllur në Thumanë



Vazhdon solidariteti i Kosovës për të prekurit nga tërmeti

Edhe pas ditës së tretë nga tërmeti, ka vazhduar solidariteti i madh i shqiptarëve të Kosovës për t'i ndihmuar të prekurit nga tërmeti i së martës, i cili ka shkatërruar shumë vendbanime në Shqipëri. Nëpër shumë komuna të Kosovës janë grumbulluar ndihma nga njerëz të vullnetit

të mirë e të cilët kanë dëshmuar lidhjen e fortë që kanë me Shqipërinë dhe popullin shqiptar.

Po ashtu, edhe kompani të ndryshme kanë shprehur gatishmërinë tyre për ndihmë. Këto ndihma të cilat po barten me autobus dhe maune përfshijnë pako ushqimore, veshmbathje, shtretër dhe të holla.

Qindra qytetarë të Kosovës gjenden në Shqipëri duke ndihmuar banorët e prekur nga tërmeti, por ka edhe të atillë që

kanë lëshuar shtëpitë e hotelet për t'i akomoduar familjet nga Durrësi derisa gjendja atje t'i kthehet normalitetit.

Kryeministri shqiptar Edi Rama ka kërkuar nga të gjithë shqiptarët që të mos dërgojnë më ndihma ushqimore dhe rroba sepse tanimë kanë arritur ndihma të mjaftueshme. "Kanë ardhur pafund dhe hapësirat e magazinimit po shteren. Në Portin e Durrësit s'ka më kapacitet për depozitimin e tyre dhe nevoja është përbushur e tejkaluar, falë shumë njerëzve, sipërmarrjeve, organizatave, institucioneve brenda e jashtë. Gjynah nga Zoti të skadojnë a të kalben nga mospërdorimi", ka shkruar Rama në profilin e vet në "Facebook", duke mohuar se po keqpërdoren ato ndihma. "Nuk ka vjedhje ndihmash e as shitje ndihmash, në asnjë lloj niveli shqetësues, por bëhet fjalë për episode krejt të parëndësishme për nga përmasa apo për shfaqje e postime provokatorësh të pashpirt, në lumin e ndihmave të solidaritetit fantastik. Ju lutemi kuptoni se problemi i emergjencës fillestare të ushqimit dhe veshmbathjes se fatkëqijve është tanimë i zgjidhur dhe i tejkaluar falë jush", ka shkruar Rama, duke i lutur shqiptarët që tani të solidarizohen për t'u përballuar për strehimin dinjitoz të të prekurve.

**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 28 NËNTOR - Numri i viktimave nga tërmeti shkatërrues i të martës ka vazhduar të rritet në Shqipëri. Në Ditën e Flamurit, më 28 Nëntor, numri i viktimave ka shkuar 46. Kërkimet për të mbijetuarit në rrënoja kanë vazhduar pa ndërprerë nga ekipet vendëse të kërkimshpëtimit, ato nga Kosova dhe nga vendet e tjera të rajonit dhe të BE-së. Ndërsa ndihmë mjekësore në spitalet e Durrësit dhe të Tiranës po marrin 657 të lënduar si pasojë e goditjes nga tërmeti.

Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë ka bërë me dije se operacionet e kërkimshpëtimit janë ndërprerë në Thumanë, në fshatin më të prekur nga tërmeti. Tri viktimat e fundit në këtë fshat janë nxjerrë në mëngjesin e së enjtes. Mes viktimave të tërmetit janë katër fëmijë dhe shumë të rinj dhe të reja. "Aktualisht në Thumanë operacioni i kërkimshpëtimit është ndërprerë pasi nuk ka informacion për trupa të tjerë nën rrënoja", ka bërë me dije

Ministria e Mbrojtjes.

Operacionet e kërkimshpëtimit kanë vazhduar në Durrës, në rrënojat e ndërtesave të shkatërruara nga tërmeti, ku ka informacione nga banorët se nën to janë ende qytetarët e pagjetur.

Lajmi i mirë për festën kombëtare ka qenë kur zjarrfikësit nxorën të gjallë 33-vjeçarin Adriatik Bode nga rrënojat e hotelit në Durrës. Ndërkohë, gjatë ditës së enjte kanë ndodhur edhe disa tërmete në Shqipëri. Një tërmet i fuqishëm prej 4.9 shkallësh goditi Shqipërinë në orën 11:25 të ditës së enjte. Epiqendra ishte në Detin Adriatik, 48 kilometra në veriperëndim të Tiranës, me thellësi prej vetëm 2 kilometrash. Gjithashtu, në orën 11:52, një tërmet tjetër 4 ballësh, po ashtu me epiqendrë në Adriatik, goditi Shqipërinë. Ky tërmet ishte 33 kilometra në veriperëndim të Tiranës, me thellësi prej 10 kilometrash. Derisa ekipet e kërkimshpëtimit kanë vazhduar nxjerrjen e trupave prej rrënojave, qindra qytetarë të zonave të prekura kanë kaluar natën e dytë mes rrënojave, nën tenda dhe në vetura.



kur pas tërmetit në Shqipëri



Pacolli dhe Kastrati dhurojnë 2.5 milionë euro për rindërtimin e objekteve të dëmtuara

Biznesmeni i njohur nga Kosova, Behgjet Pacolli, ka thënë se ishte i tronditur kur pa dëmet në jetën e njeriut dhe në infrastrukturë që tërmeti shkatërrues po lë pas në Shqipëri. Ai ka theksuar se kjo situatë kërkon solidaritet dhe mbështetje për të siguruar që qytetarët e prekur mund të kthehen shpejt në jetën normale. "Kemi vendosur, së bashku me familjen time, (ne djemtë e Isa dhe Ruhan Pacollit), që t'i dhurojmë një milion euro për

Varrosen dy vëllezërit nga Gjilani që vdiqën pas tërmetit në Shqipëri

Dy vëllezërit që kanë humbur jetën në Durrës nga tërmetet, Isa dhe Shemsedin Abazi, janë varrosur të enjten në Livoçin e Epërm të Gjilanit. Dy të ndjerët po qëndronin në hotelin "Tropikal" në Durrës i cili u rrënuar tërësisht pas goditjes nga tërmeti i së martës. Në varrimin e vëllezërve nga Livoçi i Gjilanit ka marrë pjesë edhe lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti.

Ai ka thënë se qeveria e ka për obligim ta ndihmojë dhe ta përkrahë familjen e tyre. "Ne si qeveri e kemi për obligim që ta ndihmojmë e ta përkrahim këtë familje, tragjedinë e së cilës do ta ndajmë të gjithë ne. Edhe në gëzim edhe në hidhërim do të jemi me ta. Le t'i qëndrojmë pranë kësaj familje që i humbi më të dashurit dhe duke i shprehur ngushëllim edhe për këta dy djem edhe për 40 të tjerët. Ne do



të jemi këtu që t'i mbështesim. Mërzinë e kemi të pashmang-

shme. Ju faleminderit që keni ardhur këtu pranë familjes!

Shemsedini dhe Isai u prehshin në paqe!", ka thënë Kurti.

rindërtimin e zonave të prekura nga tërmeti. Ky donacion do të shkojë në funksion të rindërtimit dhe bashkë me Qeverinë e Shqipërisë do të menaxhohet në mënyrë transparente dhe të sigurt. Kjo është më e pakta që unë dhe familja ime mund të bëjmë për Shqipërinë tonë të dashur. Mbështetja ime për vëllezërit tanë do të jetë e vazhdueshme dhe shpresoj që së shpejti ata të kthehen në normalitet. Unë pres, po ashtu, që në mënyrë të organizuar të pranoj edhe qindra familje në Prishtinë", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka falënderuar zëvendëskryeministrin në detyrë dhe ministrin e Punëve të

Jashtme, Behgjet Pacolli dhe familjen e tij për ndarjen e një milion eurove për Shqipërinë pas tërmetit që ka prekur shtetin shqiptar.

Edhe presidenti i kompanisë "Kastrati", Shefqet Kastrati dhe familja e tij, kanë vendosur që t'i dhurojnë 1.5 milion euro. Në deklaratën e tij për medie, ai ka thënë se tragjedia shqiptare e ka tronditur thellësisht atë dhe familjen tij. "Jemi munduar të ndihmojmë e të lehtësojmë sa mundemi këto ditë. Si gjithnjë, pa zhurmë. E kam dhënë në çast urdhrin e mosmarrjes së asnjë kokërr leku nga askush që ka kaluar nëpër Rrugën e Kombit për ndihmë. Pa bërë asnjë publicitet, sepse gjithmonë kam ecur me parimin: 'Kur ndihmon një

rob të Zotit në nevojë, duhet ta shohë veç ai lart!' Unë dhe familja ime kemi ndarë 1.5 milion euro që kjo dhimbje e madhe të lehtësohet sadopak", ka deklaruar Kastrati.

Gjithashtu, Grupi Parlamentar Socialist si dhe 60 kryetarë të

bashkive të vendit kanë vendosur ta dhurojnë pagën e muajit nëntor për familjet e prekura nga tërmeti në llogarinë e përcaktuar nga qeveria për fondin e rindërtimit. Po ashtu, edhe Papa Françesku ka dhuruar për Shqipërinë 100 mijë euro.

ShBA-ja në krah të Shqipërisë sikurse në vështirësi të tjera

Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) përmes një deklarate ka thënë se, ashtu sikurse në kohë të tjera të vështira, Shtetet e Bashkuara "janë përkrah miqve tanë në Shqipëri". DASH-i në këtë deklaratë ka shprehur ngushëllime për viktimat e tërmetit të kësaj jave në Shqipëri. "Derisa Shqipëria po shënon Ditën e Pavarësisë, ne shprehim ngushëllimet tona më të thella për ata që humbën jetën në

tërmetin e kësaj jave. Tani, si në periudha të tjera të vështira, Shtetet e Bashkuara janë me miqtë tanë në Shqipëri", është thënë në deklaratën e sekretarit amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, me rastin e 107-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë. Në këtë deklaratë është theksuar se nga rënia e komunizmit, tridhjetë vjet më parë, Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara kanë zhvilluar një partneritet gjithnjë e më të

fortë. ShBA-ja, me këtë rast, përshëndet përpjekjet e Qeverisë së Shqipërisë për t'i zbatuar reformat e nevojshme, përfshirë ato reforma që synojnë forcimin e një gjyqësori të pavarur. "Ne vlerësojmë thellësisht kontributet pozitive të Shqipërisë në koalicionin e NATO-s dhe mirëpresim kryesimin nga ana e Shqipërisë të OSBE-së më 2020", është thënë në këtë deklaratë.



Festa e 28 nëntorit, nën hijen e tërmetit që goditi Shqipërinë

107-vjetori i shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë ka kaluar nën hijen e tërmetit që la të vdekur mbi 45 persona dhe mbi 650 të lënduar. Në shenjë solidarizimi me viktimat, Dita e Flamurit nuk është shënuar me ndonjë aktivitet të veçantë përpos ceremonisë kryesore të mbajtur në Vlorë. Liderët institucionalë dhe politikë në Shqipëri dhe Kosovë kanë shfrytëzuar rrjetet sociale për t'i uruar shqiptarët për 28 nëntor

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 28 NËNTOR (ER) - Dita e Flamurit e ka zënë Shqipërinë dhe shqiptarët duke u përballur me pasojat e tërmetit i cili la të vdekur mbi 45 persona dhe mbi 650 të lënduar. Krahasuar me vitet e kaluara, në këtë 28 nëntor, në shenjë solidarizimi me vikti-

mat, nuk ka pasur ndonjë organizim institucional nga Shqipëria dhe Kosova. Të gjitha urimet e liderëve institucionalë dhe politikë për 107-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë kanë qenë të lidhura me ngjarjet e fundit në shtetin shqiptar. Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, pas një ceremonie të organizuar

në Vlorë për nder të 107-vjetorit të Ditës së Flamurit, ka thënë se do të vazhdojnë të angazhohen për t'i shëruar plagët e të gjitha familjeve që janë prekur nga tërmeti. Ai ka thënë se politika duhet të jetë gjithmonë bashkë në interes të shtetit dhe popullit. Ndërsa kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka uruar shqiptarët me rastin e Ditës së Flamurit, ndonëse kësaj radhe kjo ditë feste nuk është si vitet e kaluara. "Hyri Dita e Flamurit Kuqezi në errësirën që na rrethon përkohësisht, përpara daljes së diellit. Zoti e bekoftë Shqipërinë dhe shqiptarët kudoqofshin", ka shkruar Rama në llogarinë e vet në "Facebook". Ashtu si në Shqipëri, edhe në Kosovë festa e Flamurit ka kaluar nën hijen e tërmetit. Përpos zbulimit të shtatoreve të Shaban, Hamëz dhe Adem Jasharit, Agim Ramadanit dhe homazheve të Varrezat e Dëshmorëve, nuk ka



pasur ndonjë aktivitet të veçantë me rastin e 107-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se ky 28 nëntor i gjen shqiptarët të bashkuar rreth familjeve të viktimave të tragjedisë në Shqipëri. "Ditët e fundit sërish rikonfirmuam dashurinë për kombin dhe për njëritjetrin. Gjithmonë jemi frymëzuar nga guximi i grave dhe burrave që rrezikuan jetën për mirëqenien e të tjerëve", ka thënë Thaçi.

Kurse kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka thënë se

në këtë 28 nëntor janë bashkuar për t'iu bërë ballë pasojave të tërmetit që ka goditur këto ditë Shqipërinë. Kurse lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti, ka thënë se solidariteti që janë duke treguar tani për njëritjetrin është dëshmi se kur është nevojë "jemi një popull në këmbë, të gjithë për secilin, secili për të gjithë dhe bashkë do t'ia dalim". Mesazhe urimi dhe përkrahje për Shqipërinë me rastin e 28 nëntorit kanë dërguar edhe lideri i LDK-së, Isa Mustafa, i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ai i AKR-së, Behgjet Pacolli etj.



Osmani: Marrëveshja me Serbinë duhet ta përfshijë njohjen reciproke

PRISHTINË, 28 NËNTOR - Nën kryetarja e LDK-së, Vjosa Osmani, e cila njëkohësisht ishte edhe kandidat e kësaj partie për postin e kryeministres në zgjedhjet e 6 tetorit, ka thënë se marrëveshja me Serbinë duhet ta përfshijë njohjen e ndërsjellë. Në një intervistë për 'european-westernbalkans', ajo ka folur edhe rreth asaj se çfarë mendojnë të bëjnë së bashku me, siç i është referuar ajo, partneren e koalicionit, Lëvizjen Vetëvendosje, në lidhje me dialogun me Serbinë, duke thënë se deri më tani këto bisedime me Serbinë janë përdorur më shumë për t'i fshehur dështimet e qeverisë së kaluar. "Sigurisht, shumë gjëra do të ndryshojnë për të mirë. Kjo qeveri nuk do ta përdorë dialogun për t'i fshehur prapa vetes dështimet e

saj dhe të merret me politikën e brendshme, duke pasur parasysh se dialogu ishte përdorur më parë për të mbuluar çdo gabim që kishte bërë qeveria. Ajo që duam të bëjmë me partnerin tonë të koalicionit, Lëvizjen Vetëvendosje, është që të sigurohemi që të merremi si me çështjet e brendshme, po ashtu edhe me politikën e jashtme. Teksa marrëdhëniet me Serbinë mund të duken të largëta, në fakt nuk janë. Sa më shpejt që ne ta përfundojmë marrëveshjen përfundimtare me Serbinë aq më mirë për të gjithë rajonin, veçanërisht kur bëhet fjalë për krijimin e një perspektive më të mirë ekonomike për vendin tonë", ka thënë Osmani.

Ajo ka shtuar se kur takohen me investitorët e huaj dhe bizneset



vendore ata flasin për rreziqet politike dhe paparashikueshmërinë ligjore. "Ne duhet ta adresojmë këtë. Marrëveshja me Serbinë duhet të përfshijë njohje të ndërsjellë pasi kjo do të heqë çdo pengesë për ata që po mendojnë të investojnë në Kosovë. Në anën tjetër, normalizimi si i tillë deri më tani është parë më shumë

si një koncept teorik. Ne duhet të sigurohemi që ta përkthejmë atë në atë që duhet për qytetarët tanë. Kishte një marrëveshje në vitin 2010 në Asambleenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për ta filluar dialogun nën kujdesin e BE-së. Ideja ishte që të sigurohemi që nga ky proces të përfitojnë qytetarët në vend se

të shndërrohet në një shtrëngim duarsh në mes të dy liderëve dhe aty përfundon gjithçka. Për fat të keq, gjatë gjithë këtyre viteve ne e kemi parë që fokusi i BE-së ishte në shtrëngimin e duarve e jo në atë se çfarë ndodh me marrëveshjet më pas. Kjo rezultoi në 33 marrëveshje, shumica prej të cilëve nuk po zbatohen nga Serbia", ka deklaruar Osmani.

Ajo ka theksuar se ka shumëçka që mund të bëjnë. "Si LDK ne mendojmë se dialogu është e vetmja mënyrë për t'i zgjidhur çështjet me fqinjët tanë, përfshirë edhe Serbinë. Por, natyrisht ne kurrë nuk do të lejonim që çështjet si kufiri të jenë të diskutueshme si dhe çdo çështje që është e lidhur me sovranitetin tonë ose funksionalitetin tonë si një shtet i pavarur", ka thënë Osmani.

Ambasadori Dugolli ia dorëzon Erdoganit letrat kredenciale

PRISHTINË, 28 NËNTOR - Presidenti i Turqisë, Rexhep Taip Erdogan, ka pritur në takim ambasadorin e ri të Kosovës në Ankara, Ilir Dugolli. Në takim në Kompleksin Presidencial, ambasadori Dugolli ia dorëzoi Erdoganit letrat kredenciale. Dugolli bashkë me

bashkëshorten dhe disa punonjës të ambasadës janë fotografuar me presidentin turk. Ilir Dugolli është emëruar ambasador i Kosovës në Turqi më 21 gusht të këtij viti nga zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme në detyrë, Behgjet Pacolli. Ilir

Dugolli më herët ka qenë ambasador i Kosovës në Belgjikë.

Po ashtu, ai ishte akredituar ambasador i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i Republikës së Kosovës në Republikën e Estonisë, atëherë me rezidencë në Mbretërinë e Belgjikës.



Heronjtë Hamëz, Shaban dhe Adem Jashari përjetësohen në bronz në Drenas

Me rastin e festës së 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit, të heroit Gjergj Kastrioti-Skënderbeu (1443), të Ismail Qemalit (1912), ditëlindjes së komandantit legjendar Adem Jashari dhe daljes së parë publike të UÇK-së, u përjetësuan në bronz shtatoret e heronjve Shaban, Hamëz dhe komandantit legjendar Adem Jashari, në sheshin "Fehmi Lladrovci" në Drenas



**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

DRENAS, 28 NËNTOR - Nga dita e enjte sheshit kryesor të Drenasit "Fehmi Lladrovci" i janë shtuar edhe tri shtatore të reja, ajo e Shaban, Hamëz dhe Adem Jasharit. Për ta inauguruar kompletimin e figurave të historisë sonë në sheshin "Fehmi Lladrovci" kanë marrë pjesë presidenti Hashim Thaçi, kryeministri Ramush Haradinaj, lideri i shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, Ali Ahmeti, kryetari i Parlamentit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari me familje, kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, përfaqësues të tjerë nga Maqedonia, Shqipëria, Mali i Zi, Lugina e Preshevës, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, familje të dëshmorëve e qytetarë të tjerë të dy komunave. Vendosja e këtyre shtatoreve është bërë me rastin e 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit, daljes së parë publike të UÇK-së dhe

ditëlindjes së komandantit legjendar Adem Jashari.

Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se në ditën e Pavarësisë së Shqipërisë, ditën e festës së Flamurit Kombëtar, të ditëlindjes së komandantit legjendar Adem Jashari, të daljes publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është sublimuar gjithë angazhimi ynë për çlirim të vendit. "Sot sheshi 'Fehmi e Xhevë Lladrovci' po madhësohet edhe me përrurimin e shtatores së Shaban Jasharit, Hamëz Jasharit dhe Adem Jasharit. Sot po fuqizohet e po madhësohet ky shesh i figurave të bashkëluftëtarëve tanë, Ilazit, Rasimit, Bedrisë", ka thënë ai.

Kreu i vendit ka theksuar se sot ky shesh po madhësohet dhe po e dërgon mesazhin e vendosjes së emblemave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës dhe mesazhit të bashkimit kombëtar të figurave të bacës Shaban, Hamzës dhe Ademit. "Në këtë shesh po vendosen emblemat e UÇK-së, identitetit dhe krenarisë

së kombit shqiptar. Po vendosen shtatoret e kujtesës së krenarisë së kombit por, para së gjithash, edhe e mesazhit për të ardhmen e sigurt të shtetit të Kosovës dhe kombit shqiptar", ka thënë presidenti Thaçi.

Para përrurimit të shtatoreve të Shaban, Hamëz dhe Adem Jasharit në Drenas, presidenti Thaçi ka bërë nderime edhe në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz.

Ndërkaq kryeministri në largim, Ramush Haradinaj, ka thënë se Drenasi përjetëson sot në bronz tri figurat emblematike të historisë sonë të re, Shaban, Hamëz dhe Adem Jashari, të cilët, me familjen heroike Jashari ndërruan epokat, u ngritën vetë të parët t'i japin zemër popullit. Haradinaj ka thënë se ky 28 nëntor është i veçantë sepse këta tre burra na bashkojnë sot në këtë shesh, duke na bërë një në zemër, ashtu siç ishim e do të jemi gjithmonë. "Lufta heroike e UÇK-së, në ballë me komandantin legjendar, shënon rimëkëmbjen tonë si komb dhe na kujton nëpër breza e krahina, se kush jemi, duke na nxitur të krijojmë vepra të mëdha së bashku edhe në shekujt që vijnë", ka thënë Haradinaj.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, para të pranish-

mëve tha se për herë të parë, pas kalimit në faqen më të ndritshme të historisë së kombit shqiptar, sot janë sërish bashkë me ne, të shkrirë në bronz, Shaban, Hamëz dhe Adem Jashari. "Këto tri shtatore tejkalojnë çdo përmasë të shtatoreve sepse po bëhen pjesë e komunës sonë ashtu siç kanë qenë gjithmonë në mendjet dhe zemrat tona, me jetën e veprën e tyre, me ndjenjën e përgjegjësisë dhe respektit që kishin për ne, që të vazhdojmë deri në çlirim, shtetformim e shtetndërtim. Ne nuk do të ndalemi me punën tonë, zotimin tonë për ta zbatuar ligjin, me parimin se askush nuk është mbi ligjin, me transparencë e llogaridhënie jo vetëm para ligjit, por edhe para këtyre tetë heronjve, të këtij sheshi madhështor", ka thënë Lladrovci.

Edhe kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka thënë se përrurimi i tri shtatoreve të heronjve të kombit Shaban Jashari, Hamëz Jashari dhe komandantit legjendar të UÇK-së, Adem Jashari, më 28 nëntor, në sheshin "Fehmi Lladrovci", shënon ditë të madhe, ditë të re për Drenasin, për Drenicën dhe kombin tonë. "Nga sot, këtu, janë bashkë ashtu siç ishin bashkë në rrugën e idealit të

brezave për liri, me Fehmi e Xhevë Lladrovcin, Ilaz Kodrën, Rasim Kiçinën dhe Bedri Shalën, duke simbolizuar tërë një shekull rezistencë, plot një shekull të përmbyllur me luftën çlirimtare të ushtrisë sonë të lavdishme", ka thënë Bekim Jashari.

Inaugurohet edhe shtatorja e Agim Ramadanit dhe Mulla Idriz Gjilanit

Me rastin e festës së flamurit në Gjilan janë vendosur shtatorja e Agim Ramadanit dhe mulla Idriz Gjilanit. Në ceremoninë e inaugurimit të dy shtatoreve kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve lokale e qendrore dhe qytetarë të shumtë. Pas inaugurimit, kryetari i Gjilanit dhe iniciatori i ngritjes së shtatoreve, Lutfi Haziri, ka thënë se nga sot do të bashkëjetojnë dhe komunikojnë në mes vete Idriz Seferi, Mulla Idriz Gjilani e Agim Ramadani.

Shtatorja e komandantit Adem Jashari vendoset në Fushë-Kosovë

Me një ceremoni solemne të enjten në Fushë-Kosovë është bërë zbulimi i shtatores së komandantit legjendar të UÇK-së, Adem Jashari. Kryetari i Komunës së Fushë-Kosovës, Burim Berisha, ka thënë se në shtatoren e komandantit Adem Jashari

janë përjetësuar paqja dhe liria e Kosovës. Ndërsa kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari dhe përfaqësuesi i familjes Jashari ka falënderuar të gjithë ata që kanë kontribuar që shtatorja e komandantit legjendar të vendoset në Fushë-Kosovë.

Nisma bën homazhe në Prekaz, Limaj: Shqiptarët janë bashkë në të mirë e në të keq

SKENDERAJ, 28 NËNTOR (ER) - Një delegacion i Nismës Socialdemokrate, i kryesuar nga kryetari Limaj dhe kryetari i Këshillit Kombëtar, Jakup Krasniqi, kanë bërë homazhe në Prekaz me rastin e 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit, ditëlindjes së komandantit legjendar Adem

Jashari dhe daljes në skenë për herë të parë të UÇK-së. Me këtë rast, kryetari Limaj tha se sot "shënojmë ndër datat më të rëndësishme të popullit shqiptar". Kreu i Nismës tha se festa e 28 Nëntorit e ka gjetur Shqipërinë të goditur nga një fatkeqësi natyrore, por ka shtuar se si në kohë të

mira ashtu edhe në të këqija shqiptarët janë bashkë. "Ne sot bashkëndiejmë në zemrat tona me të gjithë motrat dhe vëllezërit tanë që janë të prekur nga kjo fatkeqësi. Ne jemi bashkë dhe do të jemi gjithmonë afër njerëzve që kanë nevojë për ndihmë", ka thënë Limaj në Prekaz.





Komuniteti i biznesit në Kosovë i doli në ndihmë Shqipërisë

Komuniteti i biznesit në Kosovë është mobilizuar në mënyrën më humane duke nisur kështu kontingjente ndihmash për në Shqipëri si dhe duke ofruar transport falas për të gjithë të prekurit nga tërmeti në Shqipëri për në Kosovë

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 NËNTOR - Që nga mëngjesi i 26 nëntorit, kur ndodhi tërmeti i fuqishëm në Shqipëri, komuniteti i biznesit është mobilizuar në mënyrën më humane, duke nisur kështu kontingjente ndihmash dhe duke ofruar transport falas në të dyja anët.

Po ashtu, shumë pronarë hotelesh kanë liruar dhoma për të pastrehët që janë prekur nga tërmeti.

Klubi i Prodhuesve të Kosovës

ka dërguar ndihmat e para për të prekurit nga tërmeti në Shqipëri. "Duke i përcjellë me shqetësim shumë të thellë ngjarjet e djeshme, anëtarët e Klubit të Prodhuesve, por edhe kompani të tjera, janë mobilizuar që t'u dalin në ndihmë të gjithë të prekurve nga kjo katastrofë natyrore. Ndhimat e para janë produkte të domosdoshme për të prekurit, ku janë dërguar mbi 200 tonë produkte ushqimore, por edhe dyshek, batanije dhe produkte të ndryshme të sanitarisë. Kompanitë të cilat këtë herë e kanë përkrahur këtë

aksion humanitar janë Devolli Group (Blerim Devolli), M&Sillosi dhe Comodita (Shkëlqim Devolli), Rugove (Visar Kelmendi), Fluidi (Fejzulla Mustafa), Frutex (Shaqir Palushi) dhe Flutura (Gojart Kelmendi)", u bë me dije në njoftimin e Klubit të Prodhuesve të Kosovës.

Ky klub i prodhuesve ka bërë edhe shpërndarjen e pakove të ndryshme ushqimore dhe produkteve higjienike për qytetarët e Laçit. "Duke uruar shëndet dhe mirëqenie të gjithë qytetarëve të Shqipërisë, shpresojmë se 28 Nëntori do të na presë përherë të bashkuar dhe me shumë begati", është thënë në njoftimin për media.

Po ashtu, edhe Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ka nisur kontingjentin e ndihmave për në Shqipëri. Kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi, ka njoftuar se mbi 100 tonelata ushqim, materiale higjienike dhe veshmbathje janë nisur për Shqipëri. "100 vullnetarë dhe 100 tonelata ushqime gjysmë të gatshëm, materiale higjienike dhe veshmbathje, në aksionin e koordinuar të Odës Ekonomike me bizneset, për ndihmë Shqipërisë", ka bërë me dije Rukiqi në profilin e vet në "Facebook".

OEK-u ka treguar më gjerësisht për ndihmat që kanë dërguar. "Çadra, 5000 copë; krevate me dyshek, 10 000 copë; batanije,

20 000 copë; jastëk, 20 000 copë; ngrohëse elektrike, 5 000 copë; detergjent, 15 000 kg; sapunë, 10 000 copë; ujë të pijshëm, 75 000 litra; mallra ushqimore gjysmë të gatshme (racione ushqimore), 25 000 racione; set ndriçimi për çadra, 5 000 copë; gjenerator elektrik, 200 copë; set shpërndarje energjie, 5 000 copë; dushe portative, 1 000 copë; tualete portative, 1 000 copë; sete higjienike, 25 000 copë dhe set veshmbathje, 25 000 copë", theksohet në njoftimin e OEK-ut.

Edhe kryetari i Shoqatës së Transportit Rrugor, Ruzhdi Kurtishaj, i cili është dhe kryetar i Kuvendit në Odën Ekonomike të Kosovës, ka treguar se Shoqata e Transportit Rrugor të Udhëtarëve në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës ka ofruar

ZAFIR BERISHA TËRË HOTELIN E OFRON PËR TË PREKURIT NGA TËRMETI NË SHQIPËRI

Ish-komandanti i UÇK-së nga Prizreni, Zafir Berisha, i cili njëherësh është edhe pronar i hotelit "Kështjella", ka njoftuar se ka ndërprerë aktivitetin biznesor për t'i vënë të gjitha hapësirat në dispozicion të të prekurve nga tërmeti në Shqipëri. "Të nderuar miq, gjendja e rënduar për vëllezërit tanë në Shqipëri, pasi u godit nga tërmeti, na bënë që ta ndërpresim aktivitetin tonë si biznes dhe t'i vëmë në dispozicion të gjitha dhomat e hotel/restorantit 'Kështjella' në fshatin Vlashnjë-Prizren për ata që kanë nevojë për strehim", thuhet në njoftimin e Berishës.

100 autobusë në mënyrë vullnetare për transport nga Shqipëria për në Kosovë për vëllezërit dhe motrat e prekura nga tërmeti në Shqipëri. "Shoqata e Transportit Rrugor të Udhëtarëve, në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, ofron 100 autobusë në mënyrë vullnetare për transportin e

vëllezërve dhe motrave tona të prekura nga tërmeti, gjithashtu gatishmëri vullnetare kanë shprehur disa hotele për t'i akomoduar të prekurit nga tërmeti. Ftoj të gjitha hotelet që kanë vullnetin dhe kapacitetet për akomodim të paraqiten në Odën Ekonomike të Kosovës", ka njoftuar Kurtishaj.

KEK-u jep 100 mijë euro për t'i ndihmuar të prekurit nga tërmeti në Shqipëri

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka ndarë 100 mijë euro për t'i dalë në ndihmë Republikës së Shqipërisë pas tërmetit. Me kërkesë të drejtorit Menaxhues të KEK-ut, Njazi Thaçi dhe me aprovim të Bordit të Drejtorëve, kjo shumë është dedikuar për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, për t'i ndihmuar familjet që kanë pësuar nga kjo tragjedi.

Korporata Energjetikë e Kosovës gjithashtu ka dërguar edhe ekipin e specializuar për intervenime

emergjente (kërkim-shpëtim) i cili po u del në ndihmë autoriteteve shqiptare për nxjerrjen e viktimave nga gërmadhat e krijuara pas tërmetit.

Drejtori menaxhues i KEK-ut, Njazi Thaçi, ka thënë se kjo është më e pakta që mund të bëjnë si korporatë për t'u solidarizuar me qytetarët e Shqipërisë. "Nga mëngjesi i ditës së martë jemi duke i përcjellë me shqetësim ngjarjet në Shqipëri. Ndiejmë keqardhje dhe shprehim ngushëllimet më të sinqerta për viktimat", ka thënë Thaçi.

'Z-Mobile': Brendi ynë u mbyll dhunshëm

Në mesnatën e 28 nëntorit të gjithë numrat e 'Z Mobile'-s kanë kaluar nën menaxhimin e 'Vala'-s. Lidhur me këtë ka reaguar kompania 'Z Mobile', duke e quajtur këtë mbyllje të dhunshme të brendit dhe duke e cilësuar destimulim për investitorët e huaj

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 28 NËNTOR - Nga mesnata e 28 nëntorit të gjithë numrat e 'Z-Mobile-s kanë kaluar në 'Vala'. Lidhur me këtë kalim, 'Z-Mobile' ka reaguar duke e konsideruar shkelje të të drejtave të biznesit privat si dhe destimulim për investitorët e huaj. "Sot për Festën e Flamurit ndodhi 'nacionalizimi' i investimit në Kosovë. Sot është dita kur klima linçuese, e ndërsyrë nga grupe të ndryshme të interesit politik dhe ekonomik, arriti një qëllim të turpshëm, duke uzurpuar asetet e një investimi të ligjshëm dhe legjitim në Republikën e Kosovës. Nga sot brendi 'Z Mobile' u mbyll dhunshëm, duke iu dhënë asetet e tij një ndërmarrje publike, Telekomit të Kosovës, në një rast të padëgjuar në të gjithë Evropën bashkëkohore", është thënë në reagimin e 'Z Mobile'-s, duke u shtuar se në vendin në të cilin secili politikan, secili person publik e secili qytetar kërkon investime, hapje të vendeve të reja të punës, rritje të prodhimit vendor, rritje të cilësisë së prodhimit, tenton t'i bëhet atentat njëherë prej kompanive më të suksesshme vendore, duke ia 'nacionalizuar' pronën sikur të ndodheshim në kohën e diktaturës komuniste të pas Luftës së Dytë Botërore. Çfarë sigurie për investime do të ketë ndonjë kompani e vendit ose e jashtme kur e sheh se në Kosovë ekziston mundësia që

për shkak të interesave të ngushta të grupeve të caktuara, fabrikohen situata e keqinterpretohen fakte, në mënyrë që një ditë të mbyllet një kompani dhe t'i konfiskohet prona duke u bartur në një ndërmarrje tjetër? Ka pasur shumë zhurmë dhe sulme ndaj kompanisë 'Z Mobile'. Por, të gjithë ata që kanë sulmuar e akuzuar asnjëherë nuk kanë mundur që 'argumentet' e tyre t'i vërtetojnë në gjykatë ose kudo që kanë tentuar", është thënë në këtë reagim. 'Z Mobile' ka theksuar se nuk ka edhe ndonjë biznes tjetër në Kosovë i cili u është nënshtruar më shumë trajtimeve gjyqësore, parlamentare etj. "Z Mobile' është hetuar dy herë nga gjykatat e EULEX-it dhe ka dalë e pafajshme. 'Z Mobile' ka ngritur raste ligjore në Arbitrazh Ndërkombëtar dhe ka dalë se ka të drejtë. 'Z Mobile' është dërguar sërish te gjykatat vendore pas arbitrazhit dhe përsëri ka dalë fituese. Të gjithë ata që kanë sulmuar dhe linçuar, i dinë të gjitha këto, por duket se janë verbuar nga interesi i ngushtë, derisa e gjetën një mundësi që ta mbyllin një investim të ligjshëm të Kosovës, me interpretim të padrejtë të një kontrate me Telekomin e Kosovës. As këtë herë ne nuk e kemi ulur kokën para kësaj padrejtësie të madhe dhe, përkundër vullnetit, jemi detyruar ta kërkojmë drejtësinë edhe një herë në Gjykatën e Arbitrazhit", është thënë tutje në këtë reagim. Sipas kësaj reagimi, ky brend

do ta presë verdiktin e gjyqësisë ndërkombëtare, për të cilën gjë dhe janë shprehur optimistë. "Ne jemi thellë të zhgënjyer me heshtjen e institucioneve të vendit karshi kësaj padrejtësie ndaj një biznesi kosovar, i cili është mes punëdhënësve më të mëdhenj në vend, tatimpaguesi më i madh në vend dhe që prodhon produkte të cilësisë më të lartë evropiane. Me këtë qasje të jashtëligjshme do të frikësohen të gjithë investitorët potencialë vendorë dhe ndërkombëtarë të bëjnë ndonjë investim në Kosovë. Kush garanton se kjo që ka ndodhur sot me 'Z Mobile' nuk do të përsëritet edhe me investimet e tjera vendore sa herë që ato iu shkojnë ndesh qëllimeve të fshehta të grupeve ekonomike, politike e mediale? Dmth., në Kosovë paska mundësi që çdo instancë gjyqësore ndërkombëtare dhe vendore, si dhe çdo hetim tjetër, të dalë pa shkelje, por prapëseprapë dikush të jetë më i fortë se institucionet e vendit dhe ndërkombëtare dhe ta nacionalizojë pronën e ligjshme private", thuhet në reagimin e 'Z-Mobile', duke theksuar se janë të bindur, ashtu siç kanë qenë edhe deri tani, se drejtësia ndërkombëtare do t'u japë sërish të drejtë. "Deri atëherë, duam ta shfrytëzojmë rastin t'i falënderojmë të gjithë klientët tanë të cilët na kanë mbetur të devotshëm gjatë gjithë këtyre viteve të vështira", është theksuar në reagimin e 'Z Mobile'-s.



Në UPZ u mbajt Panairi i Katërt i Karrierës



Prizren, 28 nëntor (ER) - Në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren është mbajtur Panairi i Katërt i Karrierës, i bashkorganizuar me organizatën gjermane GIZ, ku kanë marrë pjesë dhjetëra kompani nga Prizreni, rajoni dhe i gjithë vendi.

Rektori i UPZ-së, prof. asoc. dr. Ismet Temaj, bëri hapjen e punimeve të panairit dhe ka falënderuar përfaqësuesit e GIZ-it, punëdhënësit për bashkëpunimin në organizimin

e këtij panairi shumë të rëndësishëm për studentët e këtij universiteti. Ai ka theksuar se në të gjitha programet e UPZ-së dalin kadro shumë të përgatitur për tregun e punës, duke shtuar se ngjarje të tilla do të organizohen çdo vjet në UPZ.

Rektori Temaj ka falënderuar koordinatoren e këtij panairi nga UPZ-ja, prof. ass. dr. Serdan Kervan, e cila ka kryer një punë të mrekullueshme që gjithçka të shkojë mirë. Kreshnik Basha nga GIZ-i ka theksuar se kjo organi-

zatë me mbështetjen e qeverisë gjermane ka për synim t'i ofrojë studentët dhe punëdhënësit.

Prof. ass. dr. Shemi Morina, prorektor në UPZ, ka falënderuar të gjithë që kanë kontribuar, GIZ-in, kompanitë, studentët, dekanin e Fakultetit Ekonomik, në veçanti Serdan Kervanin për kontributin e dhënë që gjithçka të shkojë mirë. Kjo ngjarje ishte një mundësi e mirë ndërveprimi midis universitetit dhe punëdhënësve të profileve të ndryshme.

Prokuroria në Gjilan ka ngritur aktakuzë kundër gjashtë zyrtarëve policorë

GJILAN, 28 NËNTOR (ER) - Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër gjashtë (6) zyrtarëve policorë të Stacionit Policor në Gjakovë, të pandehurve K. Gj., B. P., G. B., A. I., M. U. dhe Sh. L. Sipas aktakuzës, i pandehuri K. Gj. më 14 nëntor 2018, në objektin e Stacionit Policor në Gjakovë ka keqtrajtuar të dëmtuarin M. A. i cili kishte qenë i arrestuar dhe i prangosur për shkak të dyshimit se kishte kryer dy vepra penale, në atë mënyrë që derisa ishte ulur në karrige, i njëjti e godet me grusht në fytyrë, me ç'rast e rrëzon në dysheme, derisa nga aty të pandehurin e largon një zyrtar policor.

Në këtë mënyrë, i pandehuri K. Gj. ka kryer veprën penale "keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike", nga neni 198, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. "Gjithashtu, edhe të pandehurit B. P., G. B., A. I. dhe M. U. kanë keqtrajtuar të dëmtuarin M. R., ashtu që me qëllim që të nxjerrin informacione, për personat e tjerë të përfshirë në kryerjen e veprave penale, për të cilat i dëmtuari ka qenë i



dyshtuar, e sulmojnë fizikisht, duke e shkakuar lëndime të lehta trupore, për të cilat është detyruar të kërkonte tretman mjekësor. Me këto veprime, të pandehurit B. P., G. B., A. I. dhe M. U. kanë kryer veprën penale "keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike", nga neni 198, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së", është thënë në njoftimin e Prokurorisë Themelore në Gjilan.

Ndërsa i pandehuri Sh. L., si person përgjegjës në Qendrën e Ndalimit në Gjakovë, nuk i ka përmbushur detyrat zyrtare, pasi iu ka mundësuar të pandehurve M. U., G. B. dhe A. I., të futen në qelinë ku ndodhej i dëmtuari M. R., të cilët pastaj e kanë keqtrajtuar duke e sulmuar fizikisht. Në këtë mënyrë, i pandehuri Sh. L. ka kryer veprën penale "keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar", nga neni 422, paragrafi 1 i KPRK-së.

Interesim i shtuar për procesin e legalizimit të objekteve pa leje në Ferizaj



FERIZAJ, 28 NËNTOR (ER) - Ditë më parë drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit, Lulzim Aliu, ka nënshkruar dokumentin e parë të legalizimit të një objekti në territorin e Ferizajt. Ky proces i stërzgatur ndër vite tashmë është zhbllkuar dhe komunat janë të gatshme ta zbatojnë gjithë rregullativën ligjore në fuqi për këtë fushë, e ndër të parat është edhe Komuna e Ferizajt. "Me 1 euro për metër katror në kategorinë e parë të

objekteve (shtëpi banimi - banim individual) dhe 2 euro për metër katror në kategorinë e dytë të objekteve (objekte të banimit kolektiv), ferizajasi kanë mundësinë që të aplikojnë për legalizimin e objekteve të tyre. Sipas rregullativës ligjore në fuqi, aplikues në këtë proces mund të jenë vetëm pronarët që objektin e tyre e kanë të ndërtuar para datës 5 shtator 2018, natyrisht duke i përmbushur edhe kushtet e kriteret e tjera, informacionet

shtesë për të cilat, zyrtarët komunalë në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit janë të gatshëm t'i ofrojnë çdo ditë pune për të gjithë të interesuarit", ka njoftuar Komuna e Ferizajt.

Kjo komunë, përkatësisht Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit, ka ftuar të gjithë qytetarët ferizajas që kanë objektet e tyre pa leje dhe që përmbushin kushtet e kriteret e lartcekura, të aplikojnë në këtë proces të zhbllkuar së fundmi.

Vihet gurthemeli i shtatores së Skënderbeut në Prizren

PRIZREN, 28 NËNTOR (ER) - Me rastin e 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit Kombëtar, të enjten në Prizren është vendosur gurthemeli i shtatores së Gjergj Kastriotit-Skënderbeu, projekt ky që ka kushtuar 70 mijë euro dhe që do të jetë i gatshëm në muajin mars të vitit të ardhshëm.

Në ceremoninë solemne të vendosjes së këtij gurthemeli kanë marrë pjesë një numër i madh qytetarësh të Prizrenit, të prirë nga kryetari i komunës, Mytaher Haskuka. Haskuka ka thënë se ky aktivitet bëhet së bashku me

"Trojet e Arbrit" dhe se janë marrë vesh që vendi ku do të vendoset shtatorja e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut ta marrë emrin e kryetrimin të madh shqiptar.

Ndërsa kryetari i Shoqatës së Intelektualëve Gjithëshqiptarë, Ndue Oroshi, vendosjen e gurthemelit për heroin më të madh shqiptar të të gjitha kohëve e ka quajtur një ditë të madhe për Prizrenin teksa ka bërë me dije se financimi i projektit do të bëhet nga qendra "Trojet e Arbrit".

Një fjalë rasti për vendosjen e

gurthemelit në vendin që në të ardhmen do të quhet sheshi "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu" ka mbajtur edhe Selim Krasniqi, kryetar i Organizatës së Veteranëve të UÇK-së në Prizren.

Ndërsa drejtori i Administratës së Komunës së Prizrenit, Osman Hajdari, ka thënë se projekti për ngritjen e monumentit kushtuar Gjergj Kastriot-Skënderbeut ka marrë mbështetjen e të gjitha partive politike në këtë komunë. Ngritja e shtatores së Gjergj Kastriot-Skënderbeut do të bëhet më 2 mars 2020.



KUSH PO IA VJEDH DRITËN KUJTESËS SONË?

Historia nuk shkruhet për t'u dukur si përrallë. Ajo kërkon një distancë kohore për të dalë sa më objektive për prezantimin e figurave kombëtare. Historia kërkon fakte e jo përralla. Historia nuk është legjendë. Ajo është pjesë e gjallë e jetës së ndodhur të njerëzve



Nga Mehmet PRISHTINA

Si kujtohet lavdia në Kosovë? Ose, me çfarë përgjegjësie institucionale e profesionale menaxhohet kujtesa jonë historike dhe sa ajo është në korrelacion me prirjet profesionale? Këto pyetje prekin

sensin e gjithë atyre që duan të kenë një raport më të drejtë me të kaluarën, me ngjarjet dhe individët, por edhe një valorizim më objektiv mbi atë që paktohet si histori.

Ne jemi dëshmitarë të një mori librash që prezantohen si monografi dhe kemi një vister ngjarjesh që kualifikohen si akademi përkujtimore dhe shumë e shumë objektivesh që marrin atributin e memorialeve, kullave, lapidarëve e përmendoreve.

Por, a ka bërë dikush një analizë më të thuktë profesionale se çfarë literature po iu ofrojmë lexuesve, sidomos në çfarë mënyrë po e shkruajmë një pjesë të së kaluarës sonë jo

shumë të largët dhe me çfarë objektivesh po e materializojmë galerinë e personaliteteve tona që sot i kujtojmë ose si dëshmorë, ose si tribunë, ose si martirë.

Historia nuk shkruhet për t'u dukur si përrallë. Ajo kërkon një distancë kohore, për të dalë sa më objektive në prezantimin e figurave kombëtare. Historia kërkon fakte, e jo përralla. Historia nuk është legjendë. Ajo është pjesë e gjallë e jetës së ndodhur të njerëzve. Historia nuk shkruhet me porosi, për hatër të dikujt, apo për motive tjera që lidhje nuk kanë me objektivitetin historiografik.

Te ne për historinë ndodhë që të shkruaj gati çdo njëri që e mendon veten intelektual. Profesionin e historianit e praktikon edhe një kategori njerëzish që në të kaluarën me historinë janë takuar vetëm kur kanë pa ndonjë ëndërr.

Të pajisur me njohuri gjysmake dhe me aparataturë të pamjaftueshme kërkimore-shkencore, kjo tufë njerëzish të vetëquajtur historian dalin pastaj të njëanshëm, sepse si çdo punë me porosi, edhe ata shkruajnë oreksit të atyre që paguajnë 'menynë'. Shpesh ndodhë që asaj 'menyje' t'i

mungojë kripa, apo salca, por kjo nuk mjafton për të mos u servuar haja.

Prandaj, jo rrallë këto vitet e fundit na ka ndodhur që të futemi në një zonë pa shije leximi të një mori librash, që për nga etiketa quheshin monografi, por për nga brendia nuk e tejkalojnë as nivelin amator të rrëfimitarisë. Gjithashtu jemi dëshmitarë të 'mbirjes' së një mori lapidarësh e memorialësh anë e kënd Kosovës kushtuar personaliteteve të ndryshme, të cilët, sipas tekeve të njerëzve, shpallen heronj, dëshmorë, martirë, tribunë etj.

Te ne nuk ka një institucion apo komision kompetent që do të përcaktonte kriteret e qarta se kush mund të jetë hero, kush dëshmor, kush martir, kush tribun etj.

Nëse në të ardhmen nuk ndodhë që të definohen qartë këto kriteret, atëherë brezat pas nesh do të kenë shumë problem ta perceptojnë drejt historinë. Do të krijohet shumë hapësirë për keqkuptime e manipulime, kurse mundësia për të ndarë të vërtetën nga ekzagjerimet, do të jetë minimale. Ashtu siç do të jenë minimale edhe shanset që të ndërtohet një ardhmëri e qartë, e liruar nga hijet e së

kaluarës.

Popujt e civilizuar që moti i kanë pastruar këto dilema. Atje ku historia iu lihet atyre që kanë më së shumti kompetencë profesionale, emrat rrugëve nuk shënohen me emra njerëzish që në të kaluarën kanë qenë prezent në procese e ngjarje të caktuara, por shënohen me numra.

Te ne të gjitha rrugët janë me emra njerëzish dhe kjo tregon për nevojën tonë që të shfaqim me çdo kusht egoizmin e shpifur familjar dhe bajraktarizmin primitiv.

Te ne çdo katund e lagje ka varreza dëshmorësh dhe pak kujt i shkon ndërmend që dëshmorëve t'u rezervohet një copë tokë, ku bashkërisht do të preheshin, ashtu siç kanë luftuar bashkërisht.

Fragmentimi i kujtesës historike përmes këtyre veprave individuale, që shpërndahen nëpër vendbanimet tona, ta kujton natën pa hënë e cila mundohet të bëjë dritë nga yjet e paktë, por janë retë e dendura ato që e pengojnë të duket drita.

A po bëhemi pa dashje edhe ne re të dendura që po e pengojmë dritën e historisë të ndriçojë të ardhmen tonë të përbashkët?

NGRITJA E ÇMIMEVE TË TPL-së (AUTOPËRERGJEGJËSIA NDAJ PALËS SË TRETË), E PAPRANUESHME



Prof. asoc. dr. Halit SHABANI

BQK-ja nuk i ka arsyetuar tarifat e TPL-së të propozuara nga K. i Sigurimeve në Kosovë, aq më keq për BQK-në kur thotë se kjo është pasojë e inflacionit! Inflacioni qenka vetëm për TPL-në, e jo edhe për të tjera çështje. Kjo, sipas saj, paska pas impakt vetëm për çmimin e TPL-s e jo për produktet e tjera, qofshin ato të KS. apo edhe te sistemi financiar në

përgjithësi... banka etj. Si qenka e mundur që të gjitha KS t'i ngritin çmimet njëkohësisht?! Vallë të gjitha i paskan shpenzimet e njëjta, paskan numër të njëjtë të punëtorëve dhe shpenzimet operative qenkan të njëjta te të gjitha kompanitë?! Çudi!

Edhe pse këto janë kompani private, TPL është sigurim i obliguar dhe ka të bëjë drejtpërdrejt me qytetarin, kompanitë nuk mund të sillen me çmimin si të duan, TPL si produkt i obligueshëm askund në botë nuk është fitimprurës përveç në Kosovë.

Ne e dimë se çmimi i një produkti të një kompanie të sigurimeve duhet të ulet apo ngritet me një analizë para-prake të aktuarit, ku secila kompani në kuadrin e saj duhet ta ketë aktuarin për këtë qëllim e jo kuturu. Kjo ngritje e çmimit nga të gjitha kompanitë bie

ndesh edhe me Ligjin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (AKK), ku besoj se kjo marrëveshje nuk do të aprovohet nga AKK-ja, e nëse po atëherë, sipas meje, edhe AKK-ja nuk e luan rolin që ka dhe nuk e zbaton ligjin konform asaj që është formuar. Shoqata e sigurimeve, po në mënyrë absurde, mundohet ta arsyetojë ngritjen e tarifave të TPL-s duke thënë se në Kosovë ka rreth 100 000 automjete të pasiguruara. Nëse qenka kështu, atëherë ata duhet t'i drejtohen Policisë së Kosovës dhe ta rrisin bashkëpunimin me këtë institucion e jo për këtë mundohet të arsyetojnë e rrisin çmimet se paska automjete të pasiguruara. Kjo nuk qëndron.

Kam dëgjuar se kompanitë e sigurimeve deklarojnë se nuk kanë fitime. Atëherë ato nuk janë deklaruar se cila është arsyeja se pse nuk paskan

fitime, për çmimet e ulëta apo për "keqmenaxhim", duke i rritur shpenzimet fiktive, duke krijuar dëme fiktive, duke deklaruar zbritjen 30 deri 50 % apo cila është arsyeja... etj.

Kompanitë, sa e di unë, tani janë duke zbatuar edhe bonus - madhusin i cili në mënyrë indirekte i ul dëmet duke e rritur kujdesin e vozitësve, po ashtu kompanitë përdorin edhe franchizën në % të caktuar që do të thotë edhe kjo ul normën e dëmeve.

Këtu nuk është bërë një analizë për ta bindur dikë se një kompani duhet t'i rritë çmimet e TPL-s, e jo të gjitha kompanitë njëkohësisht ta rrisin çmimin. Kjo të bën të dyshosh se këtu bëhet fjalë për marrëveshje mes kompanive, çka do të thotë se një gjë e tillë nuk është edhe tentativa e parë e kësaj natyre në këtë industri.


Këtu qytetari i pamundësohet

mundësia e përzgjedhjes ku, në fakt, këtu dyshimi është për një kartel mes tyre. Unë mendoj se BQK-ja qëmoti është dashur ta bëjë liberalizimin e tregut, të kërkojë nga qeveria që të hartohet Ligji për mbikëqyrjen e këtij sektori, të krijohet agjencia e veçantë e pavarur për mbikëqyrjen e kësaj industrie e jo që BQK-ja ta luajë rolin e agjencive të pavarura, pra të formohen agjencitë sikurse janë çdo kund në rajon dhe më gjerë si, p. sh., Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (AMS).

(Autori është ish-drejtor i përgjithshëm i një kompanie të sigurimeve, ish-anëtar i Bordit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe tani profesor i sigurimeve, njëkohësisht dekan në Fakultetin e Biznesit në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë)



K. R. U “Prishtina”, në vend të urimit për Ditën e Flamurit, të gjithë shqiptarëve u shpreh ngushëllime me rastin e tragjedisë së ndodhur në Shqipëri.



K. S. “Kosova e re”,
në vend të urimit për
Ditën e Flamurit, të
gjithë shqiptarëve u
shpreh ngushëllime
me rastin e tragjedisë
së ndodhur në
Shqipëri.



Kompania e Sigurimeve - Insurance Company

KOSOVA_{eRE}

E rrallë

Arkeologët kanë gjetur mumiet e disa këlyshëve të luanëve, krokodilëve, qenve dhe maceve

Ministria e Antikiteteve të Egjiptit ka prezantuar disa mumie kafshësh që janë gjetur nga ekspertët e arkeologjisë. Në mesin e shumë kafshëve të lashta janë trupat e disa këlyshëve të luanëve, krokodilëve, qenve dhe maceve si dhe disa zogjve. Gjetjet që janë bërë në pjesë të ndryshme në Saqqara të Kairos, krahas disa



artefakteve, tani janë në dispozicion për publikun. Zbulimi i tyre është bërë kohë më parë, ndërsa ekspertët i kanë hulumtuar ato lidhur me kohën kur janë punuar. Në Saqqara janë 11 piramida, derisa gjetja e mumieve të kafshëve nuk ka munguar deri më tani.

FOTO E DITES



Papa Françesku realizon një fotografi me një grup oficerësh të policisë italiane në sheshin "Shën Pjetri" në Vatikan. /AP/


E jashtëzakonshme Me çiklizëm në -17 gradë celsius

Nxënësit në një qytet të Finlandës shkojnë në shkollë me biçikleta edhe pse temperatura ka rënë në -17 gradë celsius. Të gjithë ata që merren me çiklizëm, kur ftohet moti, biçikletën e vendosin në një hapësirë të sigurt dhe presin derisa të shkrihet bora dhe të thahet uji nga reshjet. Por, kjo nuk qëndron edhe në një qytet me temperatura të ulëta në



Finlandë, ku ka rënë borë dhe i ftohti arrin në -17 gradë celsius, derisa nxënësit vazhdojnë të shkojnë në shkollë me biçikleta.

BARSOLETA E DITËS



Një burrë dhe grua shkojnë në operë. Pas një gjysmë ore që kishte filluar shfaqja, gruaja i thotë burrit: - Shiko atë burrin në krahun tënd si e paska zënë gjumi. Burri: - Për të më treguar budallallëqe më zgjon nga gjumi?

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00

The Addams Family / 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min

Rolet: Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.

Regjia: Conrad Vernon And Greg Tiernan



Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00

FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min

Rolet: Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.

Regjia: Chris Buck, Jennifer Lee



Çdo natë në ora 19:00

FORD V FERRARI

Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min

Rolet: Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfe, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.

Regjia: James Mangold



Çdo natë në ora 21:30

TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min

Rolet: Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.

Regjia: Tim Miller



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

 <p>DASHI Edhe pse jeni fiksuar pas një argumenti të caktuar sot, dikush do t'ju heqë mendjen me të dhënat që do t'ju japë për një temë komplet tjetër.</p>	 <p>DEMI Mes miqve tuaj dhe partnerit ka shumë dallime idesh. Do të jeni i pranishëm në një debat që nuk do të keni mundësi ta shmangni.</p>	 <p>BINJAKËT Shumë ditë e qetë sot. Përveç punës, nuk keni asgjë tjetër interesante që mund t'ju zë ditën. Nuk do të jeni në humor gjatë paradites.</p>	 <p>GAFORRJA Duhet të tregoheni më elastike me persona të cilët në një mënyrë apo në një tjetër ndikojnë në të ardhmen tuaj. Ndonjëherë bëni mirë të heshtni.</p>	 <p>LUANI Gjithçka që po bëni për momentin ju intrigon dhe ju jep shumë kënaqësi. Si në karrierë dhe si në çështjet personale, gjërat po shkojnë më mirë nga sa prisnit.</p>	 <p>VIrgjërësha Dukeni të përhumbur sot, por do të dalë një person që do t'ju tregojë rrugën e duhur. Keni filluar ta kuptoni rëndësinë e gjërave të vogla.</p>
 <p>PESHORJA Planetët nuk i keni në anën tuaj sot dhe duhet ta zgjidhni vetë çdo problem që mund të hasni. Ndihehi si të zënë në kurth lidhur me një situatë.</p>	 <p>AKREPI Paraqiten plane për udhëtime të largëta për ju dhe sot është dita kur do të vendosni njëherë e mirë se çfarë do të bëni.</p>	 <p>SHIGJETARI Sot nuk jeni në humor të mirë dhe do të reflektoni mbi vendime që do të peshojnë shumë në të ardhurat tuaja.</p>	 <p>BRICJAPI Shenja nervozizmi që nuk po arrini t'i kontrolloni do të shfaqen gjatë një takimi të rëndësishëm si pasojë e një neglizhence të një personi të afërt.</p>	 <p>UJORI Kjo ditë, përveç reduktimit të dukshëm të financave, do të ketë edhe probleme të tjera dhe në fund të saj do të jeni shumë të tensionuar.</p>	 <p>PESHQIT Mirë që miqtë janë gjithmonë pranë jush për t'ju qartësuar idetë sepse do ta gjeni veten në një rrëmujë të çuditshme mendimesh.</p>


Kim Kardashiani ndalon veshjet provokuese për shkak të bashkëshortit Kanye West



Kur bëhet fjalë për një simbol seksi mund të jetë disi "e ndërlikuar" për Kim Kardashian West. Në një intervistë për "The Cut", ylli televiziv ka folur për jetën e saj gjatë dekadës së kaluar dhe se si ajo ka ndikuar në kulturë. Për sa i përket shikimit si një simbol seksi, ajo tha "mund të jetë e ndërlikuar". Ndërsa flet për paraqitjet e saj

atraktive, ylli amerikan ka thënë se këtë kohë është veshur më pak seksi. "Nuk e di nëse është fakti që burri im është shprehur se ndonjëherë shumë seksi është thjesht e tepërt dhe ai nuk është i kënaqur me këtë. "Unë e dëgjoj atë dhe e kuptoj. Ende, në fund të ditës, ai gjithmonë më jep lirinë të jem dhe të bëj çfarë të dua", ka thënë Kardashian.

Babait të motrave Hadid do t'i shembet shtëpia, ndërtim i paligjshëm



Një gjykatës në Los Anxhelos ka urdhëruar babanë e supermodelueseve Xhixhi dhe Bela Hadid që ta shembë shtëpinë 100 milionë dollarësh pasi është e rrezikshme për komunitetin. Shtëpia në Bel Air, e quajtur "Starship Enterprise", përbën një rrezik për fqinjët dhe nuk respekton rregullat e ndërtimit, sipas Gjykatës

së Lartë të Los Anxhelosit. "Po të bjerë kjo shtëpi do të merrte një pjesë të lagjes me vete", ka thënë gjykatësi Krejg Karlan. Fqinjët e hodhën në gjyq 71-vjeçarën duke e akuzuar se ka bërë një ndërtim të paligjshëm. Inxhinierët që bënë verifikimet konfirmuan se ndërtuesit nuk i kanë respektuar rregullat e ndërtimit.



Morena Taraku dhuron një mijë euro për të prekurit nga tërmeti në Shqipëri

Për tërmetin e fuqishëm në Shqipëri një kontribut të madh është duke e dhënë edhe këngëtarja dhe modeluesja e njohur nga Peja, Morena Taraku. Bukuroshja, e cila prej kohësh jeton dhe vepron në Turqi, në vazhdimësi po u bënë thirrje ndjekësve të saj për të kontribu-

uar, gjë të cilën e ka bërë edhe vetë. Pas donacioneve në vlera monetare përgjatë dy ditëve që lamë pas ajo ka vazhduar sërish. E njëjta përmes platformës GoFund ka bartur sot nga xhirollogaria e saj 1 100 dollarë apo (1 000 euro), siç e ka zbuluar vetë përmes rrjeteve sociale.

Rita Ora i bashkohet thirrjes sensibilizuese për ruajtjen e oqeanëve



Kate Moss, Cara Delevingne dhe Rita Ora kanë bashkuar forcat në një fushatë të re për ta nxjerrë në pah nevojën për t'i mbrojtur oqeanet si pjesë e luftës kundër krizës klimatike. Duke qenë pjesë e një linje të studiuar me yje, e cila përfshin Pixie Geldof, Will Poulter dhe Poppy Delevingne, të famshmit kanë krijuar një video ku theksojnë se si njerëzimi duhet ta mbrojë 30

për qind të oqeanit në mënyrë që të krijojë një të ardhme të qëndrueshme për jetën në tokë. Nisur nga 'Project Zero', një iniciativë globale e mbështetur nga shkencëtarët, drejtuesit e biznesit dhe fushatat që synojnë ta rrisin vetëdijen dhe të galvanizojnë mbështetje për ruajtjen e "ekuilibrit ekologjik", filmi fton shikuesit ta "kthejnë valën kah kriza klimatike".

Vipat shqiptarë e botërorë solidar

Tërmetet shkatërruese që goditën Shqipërinë e vogël nuk 'zgjodhën' njerëzit që do të mermin me vete, mes viktimave kishte foshnja, fëmijë, të rritur dhe të moshuar. Çdo person që dha jetën në ato rrënoja kishte një histori të vetën që u la përgjysmë për të mos vazhduar më kurë.

Kjo ngjarje e rëndë me dhjetëra të vdekur e qindra të plagosur ka solidarizuar banorë të thjeshtë dhe persona të famshëm në të gjithë botën, të cilët nuk do të donin të ishin në vendin e qytetarëve shqiptarë që u prekën nga tërmeti. Vipat që u solidarizuan nga kjo situatë, postuan në profilet e tyre personale, ku më e përdorura ishte shprehja "Pray for Albania".

Pas tërmetit të fuqishëm që goditi Shqipërinë, ka reaguar këngëtarja me origjinë shqiptare Rita Ora.


Ajo ka postuar në profilin e saj një foto të flamurit shqiptar me shkrimin: "Lutuni për Shqipërinë. Zemra ime është me të gjithë të prekurit nga tërmeti."

Gjithashtu i ka bërë thirrje miqve të saj që të ndihmojnë të prekurit nga tërmeti.

Këngëtarja ka shfaqur mbështetjen e saj për ngjarjen e rëndë të ndodhur në orët e mëngjesit me pasojë vdekjen e dhjetëra personave e plagosjen e qindrave të tjerëve.

Qytetet më të prekura nga tërmeti janë Tirana, Durrësi dhe Lezha, ku shumë banesa janë kthyer në gërmadha e shumë qytetarë do e kalojnë natën nëpër çadra.

CILËT VIPA SHQIPTARË KANË HAPUR DYERT E SHTËPISË PËR TË PREKURIT NGA TËRMETI...



Ermal Fejzullahu 100 mijë euro për të prekurit nga tërmeti

Ermal Fejzullahu ka mbledhur plot 100 mijë euro për të dhuruar për të prekurit nga tërmeti në Shqipëri.

Përmes një postimi këngëtarja ka zbuluar se edhe ai i është bashkuar shumë shqiptarëve nga Kosova që po bëjnë gjithçka për ta bërë më të lehtë jetën e banorëve e zonave të prekura nga tërmeti.

"Bashkëndjenja e dhimbjes dhe dashurisë janë një! Se zemra e shqiptarit është e madhe dhe bashkëndjenja obligim, shembull është miku im i cili çdo herë i heshtur ishte pranë atyre që kishin nevojë. Të trishtuar nga dhimbja dhe pamundësia për të ndalur euro për të ndihmuar të goditurit direkt nga kjo fatkeqësi. Do të ndihmohen rastet më të rënda për

të sanuar sado pak dëmet që kanë pësuar", shkruan Ermali.



Angela Martini strehon një prej familjeve të prekura nga tërmeti

Të shumtë janë personazhet e famshme që kanë mundur të ndërmarrin iniciativa për të krijuar fondacione në ndihmë të familjeve të prekura dhe për të dhuruar para për ta.

Një prej tyre është edhe modelja, Angela Martini, e cila ka dhënë edhe lajmin e parë të mirë rreth kësaj iniciative.

"Jemi duke zhvendosur familjen e parë me fëmijë dhe pa shtëpi në një banesë sot. Video së shpejti", shkruan ajo në Instastory.

Ky veprim është vërtet emocionues dhe për t'u vlerësuar çdo ndihmë sado e vogël për të prekurit nga tërmeti!



Bebe Rexha: Do të udhëtoj personalisht në Shqipëri për të siguruar që paratë shkojnë në vend të duhur

Këngëtarja e njohur shqiptare, Bebe Rexha, nëpërmjet një videoje të publikuar në Instagram ka njoftuar se do të udhëtojë për në Shqipëri.

Ajo do të ofrojë ndihmën e saj për njerëzit e prekur nga tërmetet dhe dëshiron që të jetë pranë tyre në këto ditë të vështira.

"Ju lutem ndihmoheni Shqipërinë. Unë personalisht do të udhëtoj për në Shqipëri për t'u siguruar se paratë janë vënë në vend të duhur", ka shkruar Bebe.



'E shkatërruar nga lajmet...', Dua Lipa sensibilizohet nga tërmetet që prekën Shqipërinë

Pas tërmetit të fuqishëm që goditi



Shqipërinë, përveç Rita Orës ka reaguar edhe këngëtarja tjetër me origjinë shqiptare, Dua Lipa.

Ajo ka postuar në profilin e saj një foto të flamurit shqiptar me shkrimin: "E shkatërruar nga lajmet e këqija. Zemra dhe lutjet e mia janë me shqiptarët. Ju dërgoj gjithë dashurinë time në këtë kohë vështirë".

Këngëtarja është shfaqur shumë e prekur nga kjo ngjarje e rëndë për popullin shqiptar, ku deri tani kanë ndërruar jetë 20 persona dhe mbi 600 janë lënduar.

Qytetet më të prekura nga tërmetet janë Tirana, Durrësi dhe Lezha, ku shumë banesa janë kthyer në gërmadha e shumë qytetarë do e kalojnë nëpër çadra natën.

Këta janë ndër tërmetet më të forta ndër vite në vendin tonë, me pasojë shkatërrimin e ndërtesave dhe vdekjen e personave.



Capital T, me një kamion plot me ndihma për të prekurit nga tërmeti

Në vazhden e personave të njohur që kanë shprehur solidaritetin ndaj të prekurve nga tërmeti, është vendosur edhe Capital T. Sot, reperi ka publikuar në rrjetin social "Instagram" një foto ku shihet duke u nisur nga Prishtina me një kamion të mbushur plot me ndihma.

"Rrugës për Shqipëri"-ka shkruar

Capital T krahas fotos, duke treguar kështu se i ka qendruar fjalëve të thëna dje, se do t'i vijë në ndihmë të gjithë të prekurve nga tërmeti në çfarëdo mënyre.



Këngëtar italian, koncert për Shqipërinë

Një koncert për të ndihmuar Shqipërinë e goditur nga tërmeti. Enzo Ghinazzi, i njohur me emrin e artist Pupo, është ndër të parët nga këngëtarët italianë që përcjell mesazh në Instagram e Twitter për popullin shqiptar,

"Kam punuar në Shqipëri dhe kam njohur forcën, besnikërinë, bujarinë e popullit shqiptar. T'i bëjmë ta ndiejnë gjithë miqësinë e afërsinë tonë në këtë moment të tmerrshëm, shkruan këngëtarja. I pyetur më pas nga Corriere di Arezzo, Pupo thotë se është i gatshëm për çdo iniciativë serioze profesionale në mbështetje të Shqipërisë. Si personale, ashtu edhe me kolegët e tjerë.

"Jam gati të jap një koncert dhe të gjitha të ardhurat të shkojnë për atë popull me të cilin jetova gjashtë muaj". Eksperiencia e Pupos në Shqipëri ka qenë pesë vjet më parë, kur pranoi ofertën e Agon Channel, në nëntor 2014.



Genc Prelvukaj i cili ka ofruar shtëpinë e tij

Pas tërmeteve tronditëse në Shqipëri shumë artistë të estradës kanë treguar gatishmërinë e tyre për të pritur njerëz në shtëpitë e tyre.

Një ndër të parët që ka ofruar këtë ndihmë është reperi Genc Prelvukaj i cili ka ofruar shtëpinë e tij në Martinaj të Plavës në Mal të Zi.

"Ju njerëz të mirë në Shqipëri. Nëse njihni familje që kanë nevojë të strehohen, kanë mbetur pa kullm mbi kokë, nga tërmeti i sotëm, unë kam një shtëpi në Martinaj të Plavës në Mal të Zi, në të cilën mund të vendosen 2 familje", ka shkruar ndër të tjera Genci.



Fatmir Spahiu ka ofruar strehim për deri në 10 persona

"Deri ne 10 persona nga Shqipëria i strehoj në Kosovë deri sa gjendja të qetësohet! Nëse dini ndonjë familje me shkruani ne mesazh", ka shkruar Spahiu.

izohen për tragjedinë në Shqipëri



dhe financiare për familjet e prekura nga tërmeti.

"U zgjova nga ky lajm i trishtuar për tërmetin në Shqipëri. Lutjet nuk janë të mjaftueshme. Unë po përpiqem të gjej një organizatë që mund të dhurojmë për të ndihmuar viktimat dhe familjet e tyre gjatë kësaj kohe të vështirë.

Ju lutem më njoftoni në komente nëse ka diçka të vendosur për të ndihmuar pasi nuk mund ta gjej një të drejtë tani. Faleminderit", ka shkruar ai krahas fotos.

Gjithashtu ai ka postuar edhe një foto që është bërë virale ku përfshin mbështetjen e forcave speciale të Kosovës.

Fotoja tregon momentin e luftës së Kosovës në vitin 1999, ku vendi ynë hapi dyert për shumë familje kosovare dhe në foton bashkangjitur është pamja e autokolonës kosovare nisur drejt Shqipërisë.

"E mira nuk harrohet kurrë. Shqipëri, ata të cilët t'i i strehove, sot po të kërkojnë ndihmë. Po lutemi për ty Shqipëri", shkruhet në foto.



Këngëtares Elvana Gjata dhe Elhaida Dani shprehen emocionalisht pranë shqiptarëve të prekur nga tërmeti

Si shumë vipa shqiptarë edhe këngëtarja Elvana Gjata ka shprehur solidarizimin e saj për tërmetin që goditi vendin tonë mëngjesin e sotëm.

Krahas fotos së flamurit me shqiponjën dyjrenare ajo ka shkruar: "Këto janë momentet kur më shumë se kurrë duhet të jemi të bashkuar, të duam e të ndihmojmë njëri tjetrin, të jemi pranë atyre që hidhërimin e mbrëmjes së kaluar do ta kujtojnë gjatë gjithë jetës".


Ajo ka theksuar se më shumë se kurrë të gjithë shqiptarët duhet të jenë të bashkuar dhe ta ndihmojnë njëri-tjetrin.



Këngëtarja shqiptare që jeton në Itali, Elhaida Dani ka shprehur se është afër me mendje dhe zemër tek personat që kanë humbur të afërmit e tyre.

"Zoti na ndihmoftë! Jam me mendje dhe me zemër me të gjithë personat që kanë humbur të afër-

mit në këtë tërmet", është shprehur Elhaida.



Bleona Qereti reagon pas tërmetit: Vetëm në këto momente vështrojmë atë që ka vërtetë rëndësi në jetë

Bleona Qereti ka reflektuar mbi jetën dhe gjërat më me rëndësi pas tërmeteve që goditën Shqipërinë. Në orët e para të mëngjesit një tërmet me magnitudë 6.4 ballë ka goditur Shqipërinë, epiqendra e të cilit ishte qyteti i Durrësit.

Reagimet kanë qenë të shumta e këtu nuk ka munguar edhe ai i këngëtares Bleona Qereti.

"Zoti na ruajt. Ne dore te tij, kujtoni Zotin se sa te vegjel jemi. Uroj te jeni mire", ka shkruar këngëtarja. Ajo gjithashtu ka bërë të ditur se ajo dhe familja e saj janë të sigurt dhe janë mirë.

"I lutem Zotit që të gjithë njerëzit e mi të jenë të sigurt. Nëna, babai im dhe unë jemi mirë, vetëm në momente si kjo ne bëjmë një vështrim mbi atë që me të vërtetë ka rëndësi në këtë jetë. Shpresoj që ju dhe të dashurit tuaj janë mirë", ka përfunduar Bleona.

Kryesisht në momente fatkeqësie njeriu reflekton mbi jetën dhe ankohet shumë më pak dhe i jep rëndësi më shumë gjërave që ka.



Motrat Istrefi solidarizohen me ngjarjen tronditëse, Era poston videon nga tërmeti në shtëpinë e saj

Një prej të famshmeve shqiptare që është solidarizuar është këngëtarja Nora Istrefi, e cila mbështet gjithë shqiptarët e prekur nga tërmetet.

Nora ka publikuar në profilin e saj disa foto nga Durrësi dhe Thumana, dy prej vendeve më të prekur nga tërmeti.

Krahas fotove ajo ka shkruar: "Lutem për ju populli im". Ndërsa Era ka treguar në profilin e saj se e kshite ndjerë goxha tërmetin.

Ajo publikoi një video, në të cilën shikohen lëvizjet e objekteve në shtëpi nën lëkundjet e tërmetit. Lëkundjet e tërmetit tragjik në Shqipëri janë ndjerë edhe në Kosovë.

Krahas videos ajo ka shkruar "E kom ndje edhe un tërmetin

dje...jom tute dhe jom lute! Ama nuk e kom prite qe po zgjohna me lajme kaq te tmerrshme... Vazhdojm t'lutemi dhe t'jemi t'mire me njeri'tjetrin", ka shkruar Era.

Almeda Abazi dhe aktori turk solidarizohen me tragjedinë e popullit shqiptar

Kurse Almeda, modelja shqiptare i ka përkrahur banorët e Shqipërisë me anë të një postimi në llogarinë e saj në Instagram duke i pyetur se si janë.

Kujtojmë që të dy janë personazhe të dashur për popullin shqiptar, sidomos kur Tolgahan u martua me bukuroshen shqiptare dhe vizitoi Kosovën disa muaj më parë.



Tuna Sejdiu bëhet me Kryqin e Kuq për të ndihmuar

Edhe Tuna Sejdiu është shprehur e gatshme për t'i ndihmuar qytetarët në Shqipëri.

Tërmeti prej 6.4 shkallë të rihërit që goditi dje Shqipërinë, ka marrë jetën e shumë personave, shumë të tjerë janë lënduar, kurse dëmet janë jashtëzakonisht të mëdha. I gjithë populli shqiptarë janë mobilizuar për t'i ndihmuar qytetarët e Shqipërisë, që janë prekur na ky tërmet.

Në mesin e tyre edhe këngëtarja Tuna Sejdiu, e cila në bashkëpunim me Parkland Hospitality Group dhe Kryqin e Kuq në Shkup, do të mbajë konferencë për medie, me qëllim apelin për ndihmë ndaj familjeve në nevojë.

Konferenca do të mbahet nesër (e enjte) me fillim nga ora 11:00 në Shkup.

KY ËSHTË NJOFTIMI I PLOTË"

"Të nderuar anëtarë, Parkland Hospitality Group me mbështetjen e Kryqit të Kuq Shkup dhe sëbashku me iniciativën e Tuna Sejdiu ju fton në konferencë për shtyp, me qëllim; apel masiv për ndihmë ndaj familjeve të prekura nga fatkeqësia në Shqipëri. Pjesëmarrja dhe përkrahja juaj si komunitet biznesi do të ketë vlerë të madhe dhe do të shtojë



jë vëmendjen e këti mesazhi për mobilizim në këto çaste, që ju drejtohet gjithsecilit prej nesh si individ apo komunitet biznesesh. Ngjarja do të mbahet në restorant Four, nesër (e enjte) me fillim në ora 11:00".

Noizy: Nuk vjedh populli por organizatat

Noizy ka qenë në Durrës ditën e djeshme ku në disa video të postuara nga ai vetë shihet duke gatuar makarona e më pas ia shpërndan banorëve.

Në një postim në Instagram Noizy shkruan se kanë filluar të vidhen ndihmat që janë vënë në dispozicion të njerëzve që janë prekur nga tërmeti. "Një sqarim: Nuk vjedh populli por organizatat. Mos të keqkuptohemi, prandaj është mirë tu jepet ndihma direkt familjeve", shkruan reperin.

Mozzik me lot në sy: Arritëm diçka që se kemi bërë kurrë

Reperi Mozzik ka ofruar ndihmën e tij për shqiptarët e prekur nga tërmeti i fuqishëm 6.4 ballë, i cili ka sjellë dëme të mëdha tek populli dhe shumë viktime.

Ai ka mbërritur në Shqipëri, ku është takuar me themeluesin e fondacionit "Fundjavë Ndryshe", Arbër Hajdarin.

Që prej ditës së djeshme, reperin ka bërë thirrje për ndihmë për të gjithë ata që mund të jepnin diçka për të prekurit nga tërmeti, ndërsa ditën e sotme është befasuar nga shuma e mbledhur.

Ai ndau një postim në profilin e tij në Instagram, ku jep mesazhin emocional:

"Arritëm diçka që se kemi bërë kurrë së bashku !!!

Arritëm 1 milion dollarë para së bashku për tragjedinë e tërmetit në Shqipëri.

O Shqiptarë kurrë më të bashkuar nuk iu pasna pa, lus Zotin të jemi gjithmonë kshu në këtë ritëm !

Fshehurazi pom rrjedhin lotët , lot dhimbje për humbjen e viktimave, për trishtimin që e panë sytë e njerëzve..e ai loti i fundit po më jep shije krenarie e gëzimi, po ma zbërthen fjalën " Bashkë ia dalim" Jeta ka sprovë të shumta, çdo ditë e kemi sfidë , të qëndrojmë bashkë në diell e në shira!

Zoti është më i madhi , e vetëm te ai ndihmë kërkojmë ! Faleminderit gjithve

Tërmeti në Shqipëri, Bes Kallaku anulon premierën e filmit në Prishtinë

Ditën e nesërme aktori i humorit Bes Kallaku kishte planifikuar të mbante premierën e filmit të tij "Falco", por ngjarja e tërmetit ka bërë që ai ta shtyjë.

Përmes një postimi në profilin e tij, ai ka lajmëruar të gjithë fansat që mezi e kanë prituri ditën e nesërme.

"Të dashur miq. Ju bashkëkombas të Kosovës, Shqipërisë së përtej Drinit. Për shkak të situatës së rënduar nga tërmetet edhe në dhimbje për jetët e humbura, nuk ma bën zemra që nesër të mbaj premierën e filmit "Falco" në Prishtinë, ashtu sic ishte caktuar. Zoti ju ruajt. Ju falenderoj për zemërsisht edhe për mobilizimin tuaj dhe ndihmën që po ofroni vëllezërit!", ka shkruar Besi në profilin e tij.

Make-up artisti shqiptar Mario ofron ndihma financiare për shqiptarët e prekur nga tërmeti

Make-up artisti i njohur me origjinë shqiptare që punon më familjen Kardashian, Mario Dedivanovic është prekur nga kjo ngjarje e rëndë për popullin shqiptar.

Ai ka treguar përmes një postimi në profilin e tij, mbështetje morale

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Ballkani tregon forcën edhe në Kupë, 'Nikli' eliminon Llapin

Lideri i Superligës, Ballkani, ka treguar forcën edhe në garën e Kupës, pasi e ka eliminuar Dritën e Gjilanit pas penalltive. Llapi është skuadra tjetër e madhe që është eliminuar nga Digitalb Kupa pasi ka pësuar humbje në Drenas nga Feronikeli. Prishtina dhe Trepça '89 kanë kaluar skuadrat nga rangjet më të ulëta, Minatorin dhe Dardanët

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 28 NËNTOR - Rrethi i dytë i Digitalb Kupës së Kosovës në futboll ka qenë mjaft i 'nxehtë', pasi që dy skuadra pretendente për të fituar këtë trofe, Drita dhe Llapi, janë eliminuar nga kjo garë që dërgon skuadrën fituese në Ligën e Evropës. Të gjitha ndeshjet filluan me një minutë heshtje në shenjë respekti për viktimat e tërmetit të ndodhur në Shqipëri.

Ish-kampionia e Kosovës, Drita, u eliminua nga Ballkani i Suharekës pas penalltive, pasi ndeshja në kohën e rregullt u mbyll me rezultat të barabartë, 1-1. Të parët në epërsi kaluan mysafirët me golin e mbrojtësit Fidan Gërbeshi në minutën e 25-të, por rezultatin e barazoi ylli i skuadrës nga Suhareka, Blend Baftiu (53'). Në kohën e rregullt nuk kishte gola të tjerë të shënuara dhe skuadrat shkuan në vazhdimë, por edhe aty rrjetat mbetën



REZULTATET

Feronikeli - Llapi	1-0
Ballkani - Drita	1-1 (5-4, pas penalltive)
2 Korriku - Istogu	1-0
Dukagjini - Besa	2-1
Vëllaznimi - Ferizaj	2-4
Arbëria - Onix	1-0
Vitja - Ramiz Sadiku	5-1
Ulpiana - Liria	1-3
Malisheva - Gjilani	0-3
Dardana - Vllaznia	3-3 (4-3, pas vazhdimëve)
Dardanët - Trepça '89	0-5
Flamurtari - Vushtrria	1-3
Minatori - Prishtina	0-4
Drenica - Fushë Kosova	3-1
Trepça - Drenasi	1-1 (2-1, pas vazhdimëve)
A&N - KEN-u	4-1

të paprekura dhe skuadra fituese u vendos nga penalltitë, ku më e sigurt doli skuadra e drejtuar nga Ismet Munishi, duke fituar 5-4. Tash Dritës i mbetet të përqendrohet në kampionat, ku aktualisht zë pozitën e dytë. Njëjtë sikur skuadrës nga Gjilani, edhe Llapit i duhet të përqendrohet maksimalisht në garën për titull, pasi të enjten është eliminuar nga Kupa.

Në ndeshjen e zhvilluar në Drenas, Llapi i Tahir Batatinës pësoi humbje nga Feronikeli me rezultat 1-0, kurse të vetmin gol e realizoi tre minuta pa përfunduar ndeshja Haxhi Neziraj. "Nikli", edhe pse jo në formë të mirë në këtë edicion garash, ia arriti ta eliminojë kundërshtarin e parë

serioz në rrugëtimin drejt mbrojtjes së trofeut të Kupës. Skuadra tjetër, pretendente për trofeun e Kupës, Prishtina, regjistroi fitore të thellë kundër Minatorit (0-4), kurse 0-5 fitoi Trepça '89 ndaj skuadrës me emrin Dardanët nga Gjakova. Drenica e eliminoi Fushë-Kosovën, kurse në ndeshjen e dy skuadrave që në kampionat e kanë synim mbijetesën, fituese doli Vushtrria në përballje me Flamurtarin e Prishtinës. Ndërkohë, skuadra me emër në futbollin e Kosovës, Besa e Pejës, është eliminuar nga Dukagjini i Klinës. Klubi tjetër nga Rrafshi i Dukagjinit, Liria e Prizrenit, që sivjet bën gara në Ligën e Parë, arriti të kualifikohet pas fitore (1-3) ndaj Ulpianës.

SHKURT

Ceferin dhe Van der Praag i dërgojnë Dukës letër ngushëllimi

Tërmetet e madhe e të njëpasnjëshëm që prekën në këtë javë banorët të Shqipërisë, si pasojë e të cilëve pati shumë të vdekur dhe qindra të lënduar dhe dëme materiale, kanë shqetësuar edhe zyrtarët e lartë të futbollit evropian. Presidenti i UEFA-s, Ceferin dhe presidenti i federatës holandeze, Van der Praag, kanë dërguar një letër ngushëllimi për të gjithë të dëmtuarit nga tërmeti. Kjo letër i është dërguar presidentit të FShF-së, Armando Duka.

Muriqi rikthehet në stërvitje

Sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi, është rikthyer në stërvitje me klubin e vet, Fenerbahçe, për herë të parë pas lëndimit që ia pamundësoi atij paraqitjen për "dardanët" në kualifikime për "Euro 2020" në këtë muaj. Sulmuesi rikthehet pas dy javësh si pasojë e lëndimit të nyjës që e pësoi në ndeshjen në mes të Fenerbahçes dhe Kasimpasas. Ky është një lajm i mirë për klubin turk, por edhe për Përfaqësuesen e Kosovës, për faktin se në muajin mars do të përballet në Ligën e Kombeve me Maqedoninë e Veriut.

Mavraj: Duhet ta kërkojmë gjithmonë maksimumin

Mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë, Mërgim Mavraj ka ngritur zërin te Greuther Furthi, menjëherë pas derbit me Nurnbergun (0-0). Mbrojtësi dhe kapiteni i Kombëtares shqiptare ka kritikuar ekipin se duket shpesh sikur kënaqet me pak në fushën e lojës dhe nuk shfrytëzon çastet kur ia del të jetë edhe dominues mbi kundërshtarin. "Nuk mund të kënaqemi me rezultatin 0-0 me lojën që kemi zhvilluar, rastet që kemi krijuar, zotërimin prej 65 % të topit e gjithçka tjetër. Duhet ta kërkojmë gjithmonë maksimumin. Duhet të jemi më shumë ambiciozë dhe të mos kënaqemi kurrë me diçka që e arrijmë. Jo vetëm kaq, por nëse e kërkojmë maksimumin që në start, nëse arrijmë t'i shfrytëzojmë rastet tona për të shënuar, vazhdimi i ndeshjes bëhet edhe më i lehtë", ka deklaruar Mavraj.

Kuka dhe Kelmendi nderohen me titullin 'Ambasadorë të Vullnetit të Mirë të Kosovës'

PRISHTINË, 28 NËNTOR - Ministri në detyrë i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka nderuar me titullin "Ambasadorë të Vullnetit të Mirë të Kosovës" trajnerin e xhudos, Driton Kuka dhe kampionen olimpikë, Majlinda Kelmendi. Sipas Pacollit, ajo çfarë Kuka dhe

Majlinda kanë bërë për imazhin e Kosovës është e paarritshme nga të tjerët. "Kosova përgjatë këtyre njëmbëdhjetë vjetëve shtet u identifikua në botë me shumë figura të sportit, kulturës e shkencës, si ambasadorët më të mirë të saj. Por, puna e trajnerit të

xhudos, Driton Kuka, dhe kampiones olimpikë të xhudos, Majlinda Kelmendi, që kanë bërë për imazhin e Kosovës, është e paarritshme nga të tjerët. Për këtë kontribut sot në këtë ditë të veçantë për kombin tonë nderova të dy me titullin 'Ambasadorë të Vullnetit të

Mirë të Kosovës'. Titulli që iu dha Kukës dhe Kelmendit duhet t'i inkurajojë të gjithë sportistët kosovarë të cilët duhet ta konsiderojnë rrugën e tyre si një mundësi të promovimit të vlerave të sportit, kulturës dhe trashëgimisë sonë", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook".



Shqipëria dhe Kosova bien nga një pozitë në renditjen e FIFA-s

PRISHTINË, 28 NËNTOR - Kombëtarja e Shqipërisë dhe Përfaqësuesja e Kosovës kanë humbur nga një vend në renditjen e FIFA-s për muajin nëntor. "Kuqezinjtë" dhe "dar-

danët" nuk i mbyllën mirë kualifikimet për Kampionatin Evropian. Shqipëria barazoi 2-2 me Andorrën dhe humbi 2-0 me Francën, prandaj ka rënë në pozitën e 66-të. Ndërkohë

Kosova humbi nga Çekia dhe Anglia dhe tash ka rënë në pozitën e 115-të. Në renditjen e përgjithshme të FIFA-s nuk ka ndryshime në pesë vendet e para të saj, me Belgjikën që

vazhdon të kryesojë e ndjekur nga kampionët e botës së Francës dhe ata të Amerikës së Jugut të Brazilit për të vazhduar me Anglinë dhe Uruguain.



Kosovës i shtohet edhe një federatë sportive



PRISHTINË, 28 NËNTOR - Me nis-mën e Komitetit Olimpik të Kosovës është themeluar Federata e Lojërave dhe Sporteve Tradicionale të Kosovës (FLSTK). Në Kuvendin Themelues dhe Zgjedhor të mbajtur në "Hotel Sirius" në Prishtinë u zgjodhën organet drejtuese të kësaj federate, ndër-sa rrjedhën e Kuvendit e ndih-muan edhe drejtuesit e KOK-ut, presidenti Besim Hasani dhe sekretari i përgjithshëm, Shasivar Haxhijaj. Presidenti Hasani ka përgëzuar shoqatat dhe klubet që iu përgjigjën ftesës për ta themelu-

ar FLSTK-në, kurse ka bërë me dije se KOK-u është vetëm nis-mëtar i themelimit të kësaj feder-erate deri në zgjedhjen e organ-eve drejtuese. KOK-u kishte ini-ciuar dhe ndihmuar edhe themelimin e Federatës së Sporteve Universitare të Kosovës (FSUNK). 13 delegatët e pran-ishëm që vinin nga 10 shoqata dhe klube të rajoneve të ndryshme të Kosovës unan-imisht zgjodhën për kryetar pro-fesorin Fadil Hysaj që përfaqë-sonte Etno Fest "Syri". Në fjalën e tij, kryetari Hysaj falënderoi të pranishmit për besimin, duke thënë se do ta japë maksimumin

që bashkërisht me Bordin Ekzekutiv ta bëjnë federatën sa më funksionale. Bordi Ekzekutiv do të përbëhet nga Fejsal Shaqiri, Drilon Beqiri, Nezir Shehu, Kaltrina Hasani, Sadik Krasniqi dhe Masar Kabashi. Anëtarët e bordit unan-imisht vendosën që pozitën e sekretarit të përgjithshëm t'ia besojnë Nazmi Ibërdemajt nga Shoqata "Rugova" në Pejë. Pas themelimit të federatës, FLSTK pritet të aplikojë për anëtarësim në Komitetin Olimpik të Kosovës si dhe në Asociacionin Ndërkombëtar "Sporti për të Gjithë" (TAFISA).

Lakersat dominojnë në Perëndim, triumfojnë Toronto, Clippersi dhe Houston

TORONTO, 28 NËNTOR - Lakersat vazhdojnë ta udhëheqin renditjen në Konferencën e Perëndimit pas fitores 114-110 në fushën e New Orleansit, ndeshje me rivalitet dhe emocione. Vendësit e udhëhoqën takimin shumicën e kohës (Holiday 29 pikë), por në fund erdhi përmbysja e lakersave, ku u dallua Davis me 41 pikë. Fiton edhe skuadra e Clippersit, e cila e



mposhti me rezultat 121-119 Memphisin, një tjetër ndeshje me rivalitet dhe emocione, ku diferencën e bënë Harrelli me 24 pikë e Lou Williamsi me 22, të dy lojtarë stoli. Kampionët në fuqi të Torontos mposhtën me lehtësi 126-98 New Yorkun, takim i dominuar nga kanadezët, me të zakonshmin Siakam që realizoi 31 pikë. Pas një ndeshje të dominuar përgjatë

gjithë kohës, skuadra e Houstonit mposhti 117-108 Miamin, dy skuadra pretendente këtë sezon në NBA. Për teksanët u dallua Hardeni me 34 pikë. Skuadra e Philadelphias, falë 33 pikëve e 16 reboundeve të Embiidit, mundi 97-91 Sacramentom, ndërsa Bostoni triumfoi 121-110 ndaj Brooklynit, ndeshje ku u dallua Walkeri me 39 pikë.

SHKURT

Leonardo: Mbappe qëndron 100 % në PSG

Lëvdatat nga trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane për Kylian Mbappe, bënë që në media të aludohet për një kalim të mundshëm të yllit francez në La Liga, por për t'i përgënjeshtuar këto zëra ka menduar drejtori sportiv i parisienëve, braziliani Leonardo, i cili në një intervistë ka theksuar se nuk ka asnjë shans që 20-vjeçari të largohet nga kampionët e Francës. "Nuk e di çfarë ka thënë Zidane, nuk e kam ndjekur, e vetmja gjë që di është Mbappe qëndron me ne 100 %. Ai është një lojtar i PSG-së dhe nuk diskutohet. Rinovimi i Mbappes me PSG-në? Të shikojmë", ka deklaruar Leonardo.

Hazardi mungon 10 ditë

Ylli i Real Madridit, Eden Hazard, është lënduar në ndeshjen e Ligës së Kampionëve ndaj PSG-së. Futbollisti belgu u detyrua që të largohej nga fusha e lojës pasi pati probleme në këmbën që u dëmtua në fillimin e sezonit. Por kjo nuk ka shumë rëndësi në këto çaste. Pas ekzaminimeve u konfirmua se ai ka marrë vetëm një goditje dhe do të mungojë vetëm 10 ditë.

Hummelsi: Messi është futbollisti më i mirë që e kam parë

Kapiteni i Borussia Dortmund, Mats Hummels, nuk ka asnjë dyshim se kush është lojtari më i mirë në botë. Mbrojtësi gjerman ka thënë se nuk ka parë futbollist më të mirë se Lionel Messi në jetën e tij. "Në top formë, Messi është futbollisti më i mirë që e kam parë. Pikë. Ne nuk ishim të mirë sa duhet për ta mposhtur Barcelonën. I krijuam vetëm tri apo katër shanse të mira. Barça ishte e shkëlqyer. Messi është gjithmonë i rrezikshëm", ka thënë Hummels.

Barça i shtohet garës për Havertzin

Skuadra e Barcelonës ka shfaqur interesim për mesfushorin e Bayer Leverkusenit, Kai Havertz. 20-vjeçari u rëndit i treti në çmimin "Golden Boy" të cilin e fitoi sulmuesi i Atletico Madridit, Joao Felix. Interesim për talentin gjerman kanë treguar edhe Bayern Munchen, Liverpool, Chelsea, Manchester City dhe Real Madrid. Ndërsa kartoni i tij vlerësohet 130 milionë euro.

Nëse shkarkohet Emery, Ljungberg merr drejtimin e Arsenalit

Freddie Ljungberg pritet ta marrë drejtimin e Arsenalit në rast se shkarkohet trajneri spanjoll Unai Emery, bën të ditur "The Telegraph" të enjten. Suedezi, që ishte një nga ikonat e Arsenalit në kohën sa ishte aktiv si futbollist, do ta ketë mundësinë të sigurojë kontratë më afatgjatë te klubi londinez në postin e kryetra-jnerit, ndonëse po përmenden edhe disa kandidatë më me për-vojë për këtë post. Ljungberg aktualisht është ndihmëstrajner tek Arsenalin. Ljungberg 42-vjeçar si futbollist kishte luajtur për Arsenalin nga viti 1998 deri më 2007, duke zhvilluar plot 216 ndeshje dhe shënuar 46 gola. Ai me Suedinë luajti 75 ndeshje dhe shënoi 14 gola.

Kloppi: Kualifikimi do të jetë i vështirë

Jurgen Klopp pranon se taktikat e Carlo Ancelottit e vështirësuan lojën e Liverpoolit në përballje me Napolin (1-1). "Ata ndihen sikur kanë kaluar tashmë grupin dhe ndoshta është kështu. Këtu, të gjithë mendojnë: 'O Zot, do të jetë e vështirë' dhe do të jetë e vështirë, është shumë e qartë", ka thënë fillimisht Klopp. "Mënyra se si Napoli u vendos, nuk i ndihmoi ata që shënuan. Ata mund ta ndiqnin planin e tyre gjatë gjithë kohës. Ne duhej ta rritnim presionin gjatë gjithë kohës. Ne nuk ishim të shkëlqyeshëm, por u bëmë presion atyre. Nuk isha i kënaqur me 15 minutat e fundit të pjesës së parë. Pjesa e dytë ishte thjesht intensive dhe natyrisht nuk është e lehtë. Ata vërtet mbrojtën golin që dhanë", ka deklaruar Klopp.

REZULTATET

Boston - Brooklyn	121-110
Charlotte - Detroit	102-101
Cleveland - Orlando	104-116
Indiana - Utah Jazz	121-102
Philadelphia - Sacramento	97-91
Toronto - New York	126-98
Houston - Miami	117-108
Memphis - Clippers	119-121
Milwaukee - Atlanta	111-102
San Antonio - Minnesota	101-113
Phoenix - Washington	132-140
New Orleans - Lakers	110-114
Portland - Oklahoma	136-119
Golden State - Chicago	104-90



<p>Autor: GAZMEND MORINA</p> <p>PJESË E MEKANIKËS QË STUDIOJ LIGJET E LËVIZJES SË TRUPAVE</p> <p>MËNJANIM NGA GARA (sh.shq.)</p> <p>SHUFËR E FORTË DHE E GJATË (sh.shq.)</p> <p>PËRSHËN-DETJE ALLATURKA GLOBAL EXPERIENCE LANGUAGE</p> <p>BISHË MALI</p> <p>REGJISORI I FAMSHËM BURTON</p>	<p>PËRFAQËSUES I ZGJEDHUR PËR TË MARRË PJESË NË NJË KONGRES</p>	<p>I TMERROJ KEQAS</p>	<p>RRAFSHIM, BARAZIM LARTËSISH</p>	<p>KRYEQYTETI I JORDANISË (pashq.)</p>	<p>KËMISHË E THJESHTË PREJ PËLHURË TË BARDHË</p>	<p>INDIUM</p>	<p>BIMË BARISHTORE ME KOKRRA TË VOGLA E TË THARA (shq.)</p>	<p>"ASHTU QOFTË" (fet.)</p>	<p>EPOKA E RE</p> <p>UMA TURMAN E GDHEND</p>	<p>VEGËL MUZIKORE</p>	<p>TREISO</p>
	<p>ARMENIA</p>	<p>BASHKËT. POLITIKANI DOKLE</p>	<p>KOMANDANT ALIU (UÇK) AI QË RRI I VETËM NË MANASTIR</p>	<p>NGASËSI I "FORMULA 1" FELIPE KRYEVEPRAË E LEONARDO DA VINÇIT NË FOTO</p>	<p>PA U NXITUAR, NGADALË AKTORI EGJIPTIAN SHARIF</p>	<p>BASHKËT. NJË STINË</p>	<p>KËNGËTARJA BARALIU</p>				
	<p>ZEJTAR</p>	<p>MUNGESË GJALLËRIE, ZHVILLIMI E PËRPARIMI ZEZAKU, I ZIU</p>	<p>○</p>	<p>○</p>	<p>ZANORE FLUTURUESI I PARË SIPAS MITOLOGJISË (pashq.)</p>	<p>FUTBOLLISTI SAMUEL ... ANA RUSO</p>					
	<p>ILUZIONISTI SHQIPTAR NADIR</p>	<p>HYJNIA E DASHURISË (mit. romake) AI QË E KISH-TE DOBËSI THEMBRËN</p>	<p>○</p>	<p>KUZHINË PRANË XHAMISË MODELJA KANADEZE JESSICA</p>							
	<p>ELI FARA</p>	<p>GABZHERR, GURMAZ ROMANI I EKRAIZUAR</p>	<p>○</p>	<p>GRILLI MËNYRË E VEÇANTË E TË VESHURIT</p>		<p>ZANORE RRIJTJE E SASISË</p>					
	<p>LIQEN I MADH NË AMERIKËN JUGORE</p>		<p>○</p>	<p>YLL FILMI RRUÇETIM I TRENAVE</p>	<p>MODELJA KRASNIQI</p>	<p>BASHKËT. KAPITULL I FUNDIT NË NJË ROMAN</p>	<p>AFËRDITA DRESHAJ</p>				
	<p>ZANORE</p>	<p>SKUADËR PËRHPAJË E VALËVE (sh.shq.)</p>	<p>○</p>	<p>KONOP PYJET</p>	<p>AKTORJA CATHERINE JONES KËNGËTARJA ORA</p>						
<p>JOD, ELEKTRON, LITËR</p>	<p>KUFIZIM LUMË NË SHQIPËRI</p>	<p>○</p>		<p>I VRULLSHËM QYTET NË SLLOVENI</p>							
<p>EPOKA E RE</p>	<p>FUTBOLLISTI LIONEL ROYAL ACADEMY DANCE</p>	<p>○</p>	<p>SHTËPI PLEQSH KUVENDI I KOSOVËS</p>	<p>VËNIE E MINAVE SHPEND I EGËR, ME TRUP SA TË GJELIT (shq.)</p>		<p>BIMË BARISHTORE QË KA VLERA TË MËDHA USHQIMORE</p>					
<p>AKTORJA AMERIKANE ZELLWEGER (shqip.)</p>	<p>GRUP MAFIOZËSH INDIUM, AMPER</p>	<p>○</p>	<p>VDEKJEPRURËS FOSFOR, ERBIUM</p>		<p>BASHKËT. E ZË GJUMI DUKE NDEJUR</p>						
<p>NUKLEARE</p>		<p>○</p>	<p>PARA TË DYTËS E NDESH</p>	<p>NJËSI E VJETËR PESHE I SPËRKAT ME UJË</p>							
<p>KANAPE E GJERË DHE E GJATË SI SHTRAT</p>	<p>PESHORE ME DY PJATA KUMBARË</p>			<p>ISH FUTBOLLISTI KROAT TUDOR EDI MARFI</p>							
<p>EPOKA E RE</p>	<p>MUZIKANTI KISERI BARI, ATALANTA</p>	<p>○</p>	<p>TRUMÇAK GROSETO, IVREA</p>		<p>TEFIK OSMANI DETROIT, OHAJO</p>						
<p>PJESA MË E NGUSHTË E TRUPIT TË NJERIUT (shq.)</p>	<p>TOKË E PUNUAR, POR E PAMBJELLË ZANORE</p>	<p>○</p>	<p>SHTËGTARET BASHKËT.</p>								
<p>PËREMËR VETOR</p>	<p>I FILLOJ</p>		<p>BUKURI, HIJESHI</p>	<p>ENË E THELLË PREJ QELQI QË PËRDORËT PËR TË PIRË UJË (shq.)</p>							



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Municipality Dragas
Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit- Shërbimi pronësoro juridik
Direktorijati za Urbanizam, Katastar i Zivotnu Sredinu - Imovinska pravna sluzba



04 Br.465-1/2019

18.11.2019

Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit-Shërbimi Pronësoro-Juridik, duke vepruar sipas Vendimit të KK-së Dragash 01 Nr.020-888 të dt.03.08.2019, me qëllim të shpronësimit të sipërfaqes/ parcelës, sipas Inicijativës të Komunës së Dragashit, për- destinim të Varrezave në fshatin Brezne, Komuna e Dragashit, në lëndën e shpronësimit Nr. 465-1/2019 në bazë të nenit 11 të Ligjit për Shpronësim të Pronës së Paluajtshme Nr.03L-139 me ndryshimet e Ligjit nr.03/L205 të dt.28.10.2010, me datën 18.11.2019 miraton këtë:

VENDIM PËRFUNDIMTAR

- Shpronësohet për qëllim/ interesin publik prona e paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i qëllimit të shpronësimit për destinim të Varrezave të fshatit Brezne, Komuna e Dragashit, ngastr kad. : 01676-0 në tërësi, ZK Brezne, me kulturen livadhë klasës 5, sipërfaqja prej 5286m², qe ne elaboratin kadastral evidentohet ne emrin : Aziz (Rakip) Krasniqi 1/3, Përparim(Rakip)Krasniqi 1/3 dhe Lulzim (Rakip) Krasniqi 1/3, nga fshati Brezne, me kompensim sipas vlerësimit të përmendur në pikën 2 këtij Vendimit.
- Pjesë integrale e këtij vendimi është Akti i vlerësimit i punuar nga zyra për vlerësimin e pronës së paluajtshme/Ministria e Financave, në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronar apo zotërues të interesit, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve u janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelave të vlerësimit në shkresë përcjellëse të aktit të Vlerësimit të datës 11.11.2019.
- Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Drejtorati/zyra kompetente për shpronësim i dërgon vendimin subjektit kërkuar dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat pjesë përbërse e këtij vendimi.
- Brënda 10 (dhjetë) diteve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Komisioni për shpronësim/K, Dragash bënë shpalljen e vendimit në Gazetën zyrtare të Republikës Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madhë në Kosovë.
- Kundër këtij vendimi, subjekti kërkuar, cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe qdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nese është identifikuar apo jo në tabelat pjesë përbërse e këtij vendimi, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) diteve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë në Gjykatën kompetente, vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.
- Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pasë dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente, parashtruesi i ankesës duhet të siguroj që 5 (pesë) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në zyrën e Shërbimit pronësoro juridik në Komunën e Dragashit.
- Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, Komuna e Dragashit – Drejtorati për ekonomi, financa dhe buxhet do të paguaj plotësisht shumën e kompensimit të Shpronësimit, të përcaktuar me këtë vendim.
- Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emer të titullarit të ri, Komunës së Dragashit. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryejë veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
- Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madhë në Kosovë.

KRYETARI I KOMUNËS

Shaban Shabani



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Municipality Dragas
Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit- Shërbimi pronësoro juridik
Direktorijati za Urbanizam, Katastar i Zivotnu Sredinu - Imovinska pravna sluzba



04 Br.465-1/2019

18.11.2019

Direktorati za Urbanizam Katastar i Zastitu Zivotne Sredine – Imovinsko Pravna Sluzba postupajuci po Odluci SO-e Dragas, 01 br.020-888 të dt.03.08.2019 god, radi eksproprijacije, po svojoj inicijativi Opštine Dragas, u svrhu obezbedjenja povrsine za destinaciju gorblja u selu Bezna, Opština Dragas na osnovu 11. Zakona o Esproprijaciji nepokretne inovine Br.03L-139 sa izmenama i dopunama iz Zakona br.03/L-205, od dana 18.11.2010, donosi:

KONACNU ODLUKU

- Eksproprisa se u svrhu javnog cilja, nepokretna imovine vlasnika ili posednika interesa koji su pogodjeni potrebom za obezbedjenjem povrsine za gorblje u selu Brezna, Opština Dragas prema podacima iz odgovarajucih katastarskih evidencija, gde je predmet eksproprijacije kako sledi: cela kat. parcela 01676-0 ZK Brezna po kulturi livada 5 klase, povrsine 5286m², koje se u kat.elaboratu vode na ime: Aziz (Rakip) Krasniqi 1/3, Përparim(Rakip)Krasniqi 1/3 i Lulzim (Rakip) Krasniqi 1/3, svi iz sela Brezna uz kompenzaciju utvrdjenoj u Aktu vrednovanja iz tacke 2 ove Odluke;
- Sasatavni deo ove odluke je i Akt vrednovanja izradjen od strane Kancelarije za procenu nepokretne imovine /Ministarstvo Finasija sa tabelom, u kojem je odredjen iznos naknade za one vlasnike, odnosno posednike interesa, imovinskih prava i zakonskih interesa, koji su pogodjeni procesom eksproprijacije, na bazi tabele vrednovanja sa pratecim spisima Akta Vrednovanja od dana 11.11.2019;
- Unutar roka od 5 (pet) radnih dana nakon usvajanja ove Odluke, Komisija za Eksproprijaciju Opštine Dragas ce dostaviti Odluku subjektu podnosiocu zahteva i svim osobama identifikovanim u tabelama koje su sastavni deo ove odluke;
- Unutar roka od 10 (deset) radnih dana nakon usvajanja ove Odluke, Komisija za eksproprijaciju Opštine Dragas ce izvršiti objavljivanje ove Odluke u Sluzbenom Listu Republike Kosova i u jednoj od najtiražnijih dnevnih novina na Kosovu;
- Protiv ove dluke, subjekt- podnosilac zehteva; svaka osoba koja je vlasnik ili posednik interesa na nepokretnoj imovini ili imovinskom pravu pogodjenom ovom Odlukom; kao i svaka zainteresovana osoba koja ima neposredni i legitim materijalni interes na nepokretnoj imovini koja je predmet ove Odluke, nezavisno od toga da li je identifikovana ili nije u tabelama koje su sastavni deo ove Odluke, unutar roka od 30 (trideset) kalendariskih dana ima pravo da uputi zalbu nadleznom Sudu, samo za iznos u visini nakande odredjene ovom Odlukom;
- Unutar 5 (pet) kalendariskih dana nakon dostave Zalbe nadleznom Sudu Zalioc je obavezan da obezbedi 5 (pet) kopija zalbe i fizicki ih dostavi u kancelariji Imovinsko-ravne sluzbe Opštine Dragas;
- Unutar 2 (dve) godine od dana stupanja na snagu ove odluke, Opština Dragas preko Direktorata za privredu, finasije i budzet ce u potpunosti isplatiti iznose naknada za eksproprijasane nepokrentosti/ povrsine, pogodjene ovom Odlukom;
- Ova Odluka zajedno sa tabelarnim i grafickim delovima iste predstavlja pravni osnov za registraciju u katastarske knjige na ime novog nosioca prava Opštine Dragas. Stupanjem na snagu ove odluke katastarska kancelarija je dužna da izvrši proceduralne i tehnicke radnje za sprovođenje iste;
- Ova odluka stupa na snagu danom Objavljivanja u Sluzbenom listu Republike Kosova i u jednim od najtiražnijih novina na Kosovu.

Predsednik Opštine
Shaban Shabani



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A – Prishtinë, Ad: " Luan Haradinaj", p.n.
Tel: 038/249-424, Fax: ++381(0)38/ 249-430.
e-mail: contact@pallatirinise.com

Në bazë të vendimit të Drejtorëve, Ndërmarrja Publike Lokale PALLATI I RINISË SH.A., **shpallë:**

FTESË PËR OFERTË PËR DHËNIEN ME QIRA TË HAPËSIRAVE AFARISTE

Ftoheni që të ofertoni për marrje në shfrytëzim me qira të lokaleve afariste, zyre dhe depot të cilat janë pronë e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. Pronat e evidentuara me poshtë u jepen me qira personave juridik.

Hapësirat afariste të cilat jepen me qira:

Nr.	Adresa	Sipërfaqja	Çmimi fillestar për m ² (pa TVSH)	Nr.	Adresa	Sipërfaqja	Çmimi fillestar për m ² (pa TVSH)
1.	Lokali nr.02	102 m ²	14.78 €	11.	Depo nr.04	70 m ²	6.17€
2.	Lokali nr.44	18 m ²	18.80€	12.	Depo nr.05	60 m ²	6.17€
3.	Lokali nr.50	22 m ²	18.17€	13.	Depo nr.06	70 m ²	6.17€
4.	Lokali nr.52	42 m ²	16.80€	14.	Depo nr.07	70 m ²	6.17€
5.	Lokali nr.58	21.1 m ²	18.80€	15.	Depo nr.08	60 m ²	6.17€
6.	Lokali nr.59	18 m ²	18.80€				
7.	Lokali nr.61	58 m ²	16.80€				
8.	Lokali nr.67	12 m ²	21.00€				
9.	Lokali nr.68	23 m ²	18.17€				
10.	Lokali nr.71	6 m ²	21.00€				

Kushtet e Përgjithshme

1. Periudha e qiradhënies është për 1 (një) vit, me mundësi vazhdimi.
2. Qiramarrësi me anë të nënshkrimit të kontratës me qiradhënien, është i obliguar që të bëjë parapagimin e një shumë monetare në vlerë të një qiraje mujore në llogari të Qiradhëniesit.
3. Qiramarrësi është i obliguar që pas nënshkrimit të kontratës të bëjë sigurimin e mallit nga kompanitë e sigurimit.
4. Përveç çmimit fillestar, qiramarrësi do të paguaj plus shpenzimet tjera të parashikuara me kontratë (rrymë, pastrim, nxeheje, ujë, kanalizim).

Kriter për përzgjedhjen e ofertuesit me të favorshëm është:

1. Çmimi me i lartë i ofertuar se sa çmimi fillestar.
- Tarifa e aplikimit: 10 € (Euro). Kont: 1708020600000056

Ofertuesi duhet t'i dorëzoi këto dokumente:

1. Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe numrit fiskal (kopje)
2. Kopjen e një dokumenti identifikues të pronarit ose të përfaqësuesit të biznesit; (kopje)
3. Çmimin e ofertuar për m² i cili duhet të jetë pa TVSH (Ofertë)
4. Vërtetimin nga ATK-ja, që të dëshmojë se biznesi është aktiv;
5. Fletëpagesën për aplikim.

Ofertat nuk do të merren parasysh nëse:

1. Ofertuesi i cili ka pasur lokal me qira në Pallatin e Rinisë dhe nuk i është përmbajtur kontratës së qirasë ose ka obligime ndaj Ndërmarrjes;
2. Nëse oferta nuk i përmban të gjitha dokumentet e kërkuara;
3. Nëse Oferta arrin pas datës së skadimit të afatit të dorëzimit të ofertave të përcaktuar në shpallje.

Personat juridik të cilët duan t'i vizitojnë lokale, zyrat si dhe depot e lartcekura, mund t'a bëjnë, nga data: **28.11.2019**, deri me datën: **05.12.2019**, nga ora 10⁰⁰ deri në ora 15⁰⁰.

Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur me datën: **06.12.2019** nga ora 10⁰⁰ deri në orën 12⁰⁰, në zyrën e arhivës së qiradhëniesit N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të specifikohet: emri i ofertuesit, nr i lokalit, zyrës ose depon dhe kontaktet, si: email-i zyrtar, dhe/apo nr. i telefonit.

Ofertat do të hapen nga ana e komisionit, me datë: **06.12.2019**, nga ora: **12:30**, në prezencën e ofertuesve, në zyrën e Drejtorisë së Pallatit të Rinisë në Prishtinë.

Kërkesa (aplikacioni) mund të kërkojë përmes email-it: arditah@pallatirinise.com, në formë fizike në zyrën nr. 17, apo të shkarkohet nga faqja zyrtare e "Pallatit të Rinisë": <http://www.pallatirinise.com/>.

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Planjane"

Komuna: Prizren

Data: 27.11.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/089-G/1.1	Furnizimi me aparate teknologjike

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles SHFMU "Planjane" Planjane, Prizren. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

Furnizimi me aparate teknologjike (Furnizimi Smart tabela – 2 kom)

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishtë teknik në adresën e SHFMU "Planjane" Planjane, Prizren, më së largu deri më **05.12.2019**.

4. Specifikimi i hollësishtë teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra, do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Alen Azari

Telefoni: 044/356-448

E-maili: o.s.planjane@hotmail.com



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A – Prishtinë, Ad: " Luan Haradinaj", p.n.
Tel: 038/249-424, Fax: ++381(0)38/ 249-430.
e-mail: contact@pallatirinise.com

Na osnovu odluke Borda, Lokalno Javnog Proizvedaca PALLATI I RINISË-A.D, **Objavluje:**

POZIV ZA PONUDU ZA IZDAVANJE POD KIRIJOM POSLOVNOG PROSTORA

Pozivate se da ponudi te za uzimanje na koriscenje pod kirijom poslovnog prostora, kancelarije I magacine koje su vlasnistvo L.J.P. "PALLATI I RINISË" A.d. Dole navedeno vlasnistvo se izdaje pod kirijom pravnim licima.

Poslovni proctor:

Br.	Adresa	Povrsina	Osnovna cena po m ² (bez PDV)	Br.	Adresa	Povrsina	Osnovna cena po m ² (bez PDV)
1.	Lokal br. 02	102 m ²	14.78 €	11.	Depo nr.04	70 m ²	6.17€
2.	Lokal br. 44	18 m ²	18.80€	12.	Depo nr.05	60 m ²	6.17€
3.	Lokal br. 50	22 m ²	18.17€	13.	Depo nr.06	70 m ²	6.17€
4.	Lokal br. 52	42 m ²	16.80€	14.	Depo nr.07	70 m ²	6.17€
5.	Lokal br. 58	21.1 m ²	18.80€	15.	Depo nr.08	60 m ²	6.17€
6.	Lokal br. 59	18 m ²	18.80€				
7.	Lokal br. 61	58 m ²	16.80€				
8.	Lokal br. 67	12 m ²	21.00€				
9.	Lokal br. 68	23 m ²	18.17€				
10.	Lokal br. 71	6 m ²	21.00€				

Opsti uslovi

1. Rok ugovora je godinu dana sa mogucnoscu ponovnog produzenja,
2. uzimaoc lokala je duzan da uplati jednu kiriju- ratu po potpisivanju ugovora
3. Uzimaoc lokala je duzan da osigurava svoje imovinu ,material,kod osiguravajuci drustva,
4. Uzimaoc lokala je duzan da pored osnovne cene lokala da uplati dodatne troskove kao sto je propisano u ugovorom kao sto: je {struja,cistocu,grejanje, vodovod I kanalizaciju}.zz

POVOLJNI USLOVI ZA DOBIJANJE LOKALA

1. Najveca cena od onovne cene

Uplata za aplikaciju: 10 Euro, Z.R: 1708020600000056

Ponudilac treba da predaje ova dokumenta:

1. Uverenje o registraciju bisnisa I fiskalni broj –Fotokopje
2. Dokumentat za indentifikaciju lica -Fotokopje
3. Cena za ponudu po m²,koja treba da bude bez PDV
4. Potvrda od UPK koje svedoci da je aktivan bisnis,
5. Uplatni list za aplikaciju.

Ponuda nece se uzimati u obzir u koliko:

1. Ponudilac koji imao ili ima local u ovo produzece a nije izvrsio svoje obaveze propisane ugovorom,
2. U koliko ponuda ne poseduje kompletu dokumentaciju,
3. Ako se ne dostavi ponuda na odrdjenom roku propisano u uslovima obavestjenja...

Lice koja zeli da posecuje gore navedeni poslovni prostor, mogu da posecuje od datuma: **28.11.2019** do **05.12.2019**, Od: 10⁰⁰ do 15⁰⁰.

Ponuda treba da se preda u zatvorena u koverti datumom: **06.12.2019**, od **10⁰⁰** do **12⁰⁰**, u Arhivi Proizvedaca L.J.P "PALLATI I RINISË" A.d. Na spoljnoj strani koverta treba da bude upisano: Ime i Prezime ponudioca br.lokala ili kancelarije ,email adresa ili br.telefona. Ponude bice otvorene od strane komisije datumom : **06.12.2019** od **12:30**, javno pred licima ponudioca,u kancelarija uprave proizvedaca. Zahtev (aplikacija) mozete pronaći na (email adresu): arditah@pallatirinise.com, ili licno mozete podici u kancelariji br.17, ili preuzeti sa zvaničnog sajta "Pallati i Rinise" : <http://www.pallatirinise.com/>.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](https://www.instagram.com/lumesdetails)

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftojmë të interesuarit se me datën 9 Dhjetor 2019 (e hënë) me fillim në orën 11:00 Bsc. e dipl. Blerta Restelica, mbron punimin e Masterit me titull: "Hulumtimi i përhapjes së sëmundjeve të ndryshme me theks të veçantë kancerit të mjedrës (Agrobacterium tumefaciens) te mjedra e kultivuar në rajonin e Podujevës". Mbrojtja publike do të jetë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpeite

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Adnan Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "Bajram Curri" Krushë e Madhe

Ali Dakaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Dëshmorët e Kabashit" Korishë.

Bashkim Kyqyku shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

Naser Shala shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

Dragoljub Shemiq shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

Roland Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçantë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

AUTOSHKOLLA "RITMO - L"



Auto Shkolla "RITMO - L" Prishtinë

**Eksperiencia jonë
- përfitimi i juaj.**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333



Gëzuar 28 Nëntori!

Festën kombëtare e shënojmë të bashkuar!



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales